




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2025

Prishtinë, prill 2026

# Përmbajtja

<b>FJALORI I SHPREHJEVE</b> .....	<b>3</b>
<b>FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME</b> .....	<b>4</b>
<b>VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT</b> .....	<b>6</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>8</b>
<b>Kapitull I - Pavarësia dhe Korniza Ligjore</b> .....	<b>17</b>
1.1. Pavarësia institucionale.....	17
1.2. Mandati.....	18
<b>Kapitull II - Qeverisja e brendshme dhe etika</b> .....	<b>21</b>
2.1. Plani strategjik, operativ dhe plani vjetor .....	21
2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ .....	22
2.3. Komunikimi i brendshëm.....	24
<b>Kapitulli III – Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi</b> .....	<b>27</b>
3.1. Cilësia e auditimit dhe raportimi .....	27
3.2. Auditimet e realizuara në vitin 2025.....	28
3.3. Auditimet e planifikuara .....	30
3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë.....	31
3.5. Auditimet e performancës .....	34
3.6. Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Auditim.....	40
3.7. Rishikimi i Cilësisë së Angazhimeve .....	40
<b>Kapitulli IV - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ</b> .....	<b>43</b>
4.1. Menaxhimi financiar .....	43
<b>Kapitulli V- Burimet Njerëzore</b> .....	<b>51</b>
5.1. Burimet Njerëzore dhe zhvillimi profesional .....	51
5.2. Zhvillimi profesional.....	54
5.3. Auditorët e ZKA-së përfundojnë me sukses programin “LOTA Pioneers” .....	56
5.4. Shërbimet e përbashkëta.....	57
5.5. Teknologjia Inforamtive.....	59
<b>Kapitulli VI - Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme</b> .....	<b>63</b>
6.1. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit .....	63
6.2. Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës.....	68
6.3. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit.....	68
6.4. Sinjalizimet e pranuar gjatë vitit 2025 .....	69
6.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, Marrëveshjet Dypalëshe dhe pjesëmarrja në konferenca e punëtori.....	69
6.6. Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2025 .....	75
<b>Kapitulli VII – Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2025</b> .....	<b>77</b>
7.1. Llogaridhënia e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) .....	77
7.2. Aktivitetet e ZKA-së gjatë vitit 2025.....	77
<b>SHTOJCA</b> .....	<b>80</b>
<b>Shtojca I. Auditimet për sezonin 2024/25 dhe 2025/26</b> .....	<b>81</b>
<b>Shtojca II. Pasqyrat Financiare Vjetore të ZKA-së për vitin 2025, të paaudituar</b> .....	<b>85</b>

## FJALORI I SHPREHJEVE

<b>AP</b>	Auditori i Përgjithshëm
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BRE</b>	Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
<b>CIPFA</b>	Instituti i Certifikuar për Financat Publike dhe Kontabilitet (ICFPK)
<b>EUROSAI</b>	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>GPK</b>	Granti i Performancës Komunale
<b>IBK</b>	Instituti Bujqësor i Kosovës
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA)
<b>ISA</b>	Institucioni Suprem i Auditimit
<b>IDI</b>	Iniciativa e INTOSAI-t për Zhvillim
<b>KMDK</b>	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
<b>KIDP</b>	Korniza e INTOSAI-t për Deklaratat Profesionale
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KOSTT</b>	Kompania për Operimin e Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut të Energjisë Elektrike
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MFPT</b>	Ministria e Financave, Punës dhe Trasfereve
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>NP</b>	Ndërmarrje Publike
<b>OB</b>	Organizata Buxhetore
<b>OSHC</b>	Organizatrat e Shoqërisë Civile
<b>PFV</b>	Pasqyrat Financiare Vjetore
<b>RVP</b>	Raporti Vjetor i Performancës
<b>RVA</b>	Raporti Vjetor i Auditimit
<b>RFV/BK</b>	Raporti Financiar Vjetor i Buxhetit të Kosovës
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>PSH</b>	Prokuroria e Shtetit
<b>SITP</b>	Sistemi i Tatimit në Pronë
<b>SNA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>ZKAS</b>	Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë
<b>SNISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>SITA</b>	Sistemin Informativ i Teknologjisë së Auditimit
<b>SMPK</b>	Sistemi për Menaxhimin e Performancës Komunale
<b>SHSKUK</b>	Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
<b>TI</b>	Teknologjia Informative
<b>UN</b>	Kombet e Bashkuara (KB)
<b>ZKA</b>	Zyra Kombëtare e Auditimit
<b>ZvAP</b>	Zëvendës Auditor i Përgjithshëm
<b>ZRRE</b>	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

## FJALA E AUDITORES SË PËRGJITHSHME



**Vlora Spanca**  
Auditore e Përgjithshme

Roli i Auditorit të Përgjithshëm dhe i Institucionit Suprem të Auditimit mbetet një nga shtyllat themelore mbi të cilat ngrihet arkitektura e llogaridhënies publike dhe e qeverisjes demokratike. Ky rol shkon përtej kufijve të kontrollit thjesht teknik, të financave publike; afirmohet si garanci kushtetuese për transparencë, integritet institucional dhe menaxhim të përgjegjshëm të parasë publike. Pikërisht në këtë funksion, auditimi shndërrohet në mekanizëm të domosdoshëm të baraspeshës institucionale dhe në një ndër faktorët vendimtar për ndërtimin dhe forcimin e besimit të qytetarëve ndaj shtetit.

Në një kohë kur pritshmëritë për efikasitet, etikë dhe llogaridhënie rriten pandërprerë, roli i Zyrës Kombëtare të Auditimit është vendimtar. Përbushja e misionit tonë nis me respektimin e pakompromis të mandatit kushtetues dhe ligjor, vazhdon me zbatimin e një qasjeje të qëndrueshme, të mbështetur në evidencë dhe në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit, dhe kulmon me arritjen e

ndikimit të matshëm dhe krijimin e vlerës së qëndrueshme për qytetarët.

Në këtë frymë, edhe gjatë vitit 2025, Zyra ushtroi mandatin e saj me pavarësi të plotë, integritet të lartë profesional dhe përgjegjësi të konsoliduar institucionale. Përmes vlerësimeve të pavarura, objektive dhe të ndershme, ajo kontribuoi në informimin e publikut dhe palëve të tjera të interesit, duke forcuar transparencën dhe inkurajuar një kulturë më të avancuar të llogaridhënies në sektorin publik.

Ky angazhim është reflektuar qartë edhe në realizimin e plotë të Planit Vjetor të Auditimit për sezonin 2024/2025, ku janë përmbyllur 133 auditime dhe janë publikuar raporte me cilësi dhe rezultate domethënëse. Ky rezultat dëshmon jo vetëm kapacitete të larta profesionale, por edhe pjekuri të dukshme institucionale. Shtrirja e auditimeve në organizata me kompleksitet të lartë, e shoqëruar me vëmendje të shtuar ndaj monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, flet për një orientim gjithnjë e më të qartë drejt ndikimit të qëndrueshëm dhe përmirësimit real të qeverisjes publike.

Paralelisht me këtë progres, në planin institucional dhe ndërkombëtar, Zyra konsolidoi edhe më tej pozitën e saj si partner i besueshëm në rrjetin e institucioneve supreme të auditimit. Megjithatë, zhvillimet në bashkëpunim me Kuvendin gjatë vitit 2025 ndikuan në ritmin e shqyrtimit parlamentar të raporteve të auditimit, duke reflektuar sfida që kërkojnë adresim për funksionimin e plotë dhe efektiv të ciklit të llogaridhënies demokratike.

Në të njëjtën kohë, gjetjet e auditimeve vazhdojnë të evidentojnë dobësi strukturore në menaxhimin financiar dhe në sistemet e kontrollit të brendshëm. Edhe pse janë shënuar përmirësime në disa fusha, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet nën pritshmëritë, duke nënvizuar nevojën për mekanizma më

të fortë dhe më efektive të përgjegjësive institucionale. Në këtë kuptim, nuk mund të mos e theksoj se, mungesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, fokusimi i personave përgjegjës në zhvillimin e zgjedhjeve në nivel qendror dhe lokal përgjatë vitit 2025 reflektoi me ndikim të konsiderueshëm në këtë drejtim.

Përkundër këtyre sfidave, Zyra ka ruajtur stabilitet institucional dhe ka avancuar sistemet e saj të brendshme. Në këtë progres, roli i stafit është thelbësor. Këtë e konfirmon edhe vetëvlerësimi i brendshëm, ku pjesëmarrja e lartë e stafit pasqyron jo vetëm kulturë të fortë institucionale dhe besim të ndërsjellë, por edhe vetëdije të qartë për prioritetet dhe drejtimet ku duhet të vazhdojmë të përqendrojmë përpjekjet tona. Mbi këtë bazë të konsoliduar të brendshme, Zyra ka fuqizuar edhe veprimin e saj në raport me institucionet e tjera.

Në funksion të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së interesit publik, Zyra ka intensifikuar bashkëpunimin me organet e drejtësisë, duke referuar rastet e identifikuara gjatë auditimeve. Ky angazhim dëshmon për rolin tonë aktiv në forcimin e mekanizmave të përgjegjësive dhe në promovimin e integritetit publik.

Të gjitha këto përpjekje janë pjesë e vizionit të qartë strategjik për të thelluar dhe konsoliduar besimin e publikut në raportet e auditimit dhe në rolin e institucionit tonë si mekanizëm sigurues i transparencës dhe llogaridhënies. Ky vizion nuk është thjesht orientim programor, por angazhim i qëndrueshëm për të ndërtuar një institucion që krijon vlerë publike përmes profesionalizmit, pavarësisë dhe ndikimit real në përmirësimin e qeverisjes. Në këtë kuptim, besueshmëria nuk merret si e mirëqenë, por fitohet dhe mirëmbahet çdo ditë përmes cilësisë së punës, integritetit të pakompromis dhe përgjegjësive ndaj qytetarëve tanë.

Në përmbyllje, shpreh mirënjohjen time të sinqertë për stafin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, për përkushtimin, profesionalizmin dhe angazhimin e tyre për të sjellë këto rezultate të cilat përmban ky Raport. Falë kësaj, Zyra vazhdon të fuqizohet dhe të prijë në rajon si institucion i besueshëm dhe me ndikim në jetën e qytetarëve. Njëkohësisht, falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e audituara për bashkëpunimin e deritanishëm, duke shprehur bindjen se vetëm përmes një angazhimi të përbashkët dhe të qëndrueshëm mund të avancojmë transparencën, të forcojmë llogaridhënien dhe të ndërtojmë një administratë publike më të përgjegjshme, më efektive dhe më të denjë për besimin e qytetarëve.

Me respekt,  
**Vlora Spanca**  
Auditore e Përgjithshme

*Prishtinë, 2026*



## VIZIONI

Institucion Suprem i Auditimit i besueshëm dhe model që i shton vlerë përdorimit të fondeve publike.

---



## MISIONI

Nëpërmjet auditimeve cilësore ofrojmë siguri në shfrytëzimin e pasurive dhe parasë publike, me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe rritjen e llogaridhënies publike.



## VLERAT E ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

### Pavarësia

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

### Profesionalizmi

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga principet dhe standardet në kuadër të Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t dhe nga praktikat më të mira të vendeve tjera.

### Integriteti

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet në mënyrë të ndershme dhe jashtë çdo konflikti të interesit.

### Transparenca

ZKA-ja është organizatë e hapur dhe do t'i bëjë publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu do t'i ofrojë publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja angazhohet që të promovojë transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

### Fryma ekipore

Në ZKA procesi i auditimit kryhet në mënyrë profesionale dhe bashkëpunuese në mes kolegëve në ekip dhe në nivele të ndryshme organizative, kështu promovojmë frymën ekipore si vlerë e shtuar për ZKA-në.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


Në vitin 2025, Zyra Kombëtare e Auditimit ka vazhduar të përmbushë mandatin e saj kushtetues dhe ligjor duke ofruar informacione të pavarura dhe objektive për Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët. Kjo ka kontribuar në vlerësimin e mënyrës se si institucionet publike kanë menaxhuar paratë publike, nëse kanë vepruar në përputhje me kërkesat ligjore dhe me efikasitet, përfitimet e të cilave shkojnë në dobi të qytetarëve.

Plani Vjetor i Auditimit për sezonin 2024/2025 është realizuar<sup>1</sup>. Gjatë vitit 2025 kemi kryer gjithsej 133 auditime, prej të cilave 104 ishin auditime financiare/të pajtueshmërisë, 14 auditime të performancës, 12 auditime të pajtueshmërisë dhe tre auditime me nivel të informacionit të klasifikuar - angazhime të drejtpërdrejta të raportimit<sup>2</sup>

Në kuadër të auditimeve gjatë sezonit auditues, përveç organizatave buxhetore, janë përfshirë edhe ndërmarrje publike si institucione me kompleksitet më të lartë, përfshirë: Korporatën Energjetike të Kosovës, Trepçën, KOSTT, KRU „Iber Lepenci” sh.a-Prishtina etj. Gjatë kësaj periudhe është kryer gjithashtu monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe janë shqyrtuar proceset e administrimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe burimeve njerëzore. Po ashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar komunikimit të brendshëm dhe bashkëpunimit me palët e jashtme të interesit.

### Rezultatet e punës audituese për vitin 2025

#### NUMRI I AUDITIMEVE SIPAS LLOJIT



1 PVA mbulon periudhën e sezonit të auditimit shtator –gusht, ndërsa RVP mbulon vitin kalendarik prandaj edhe mund të dallon edhe numri i auditimeve sipas këtyre dy raporteve.

2 Sipas SNISA 4000 ekzistojnë dy lloje kryesore të auditimeve të pajtueshmërisë "angazhim direkt i raportimit" dhe "angazhim i vërtetimit". Në angazhimet e raportimit të drejtpërdrejtë të kryera me siguri të arsyeshme, audituesit deklarojnë në përfundimin e auditimit se lënda është ose nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e zbatueshme, ndërsa në një "angazhim vërtetimi" me siguri të arsyeshme, konkluzionet e auditorëve shprehin pikëpamjet e tyre se informacioni i çështjes është ose nuk është në përputhje me kriteret e zbatueshme.

- **Auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë** - Janë realizuar gjithsej **104 auditime**, për të cilat janë përgatitur raportet përkatëse. Fokusi kryesor i këtyre auditimeve ka qenë: cilësia e raportimit financiar (nëse pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale), efikasiteti dhe efektiviteti i sistemeve të kontrollit të brendshëm, pajtueshmëria e veprimeve të subjekteve të audituara me kornizën ligjore, si dhe çështje të tjera që lidhen me vlerën për para.
- **Auditimet e performancës** - Janë realizuar **14 auditime të performancës**, për të cilat janë përgatitur raportet përkatëse. Këto auditime kanë mbuluar fusha me interes të drejtpërdrejtë për qytetarët, Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në: mirëqenie ekonomike dhe sociale, arsim dhe kulturë, menaxhim, shëndetësi, zhvillim dhe buxhet, prokurim publik, si dhe teknologji të informacionit.
- **Auditimet e pajtueshmërisë** - Janë realizuar gjithsej **12 auditime të pajtueshmërisë** për të cilat janë përgatitur raportet përkatëse. Fokusi kryesor i këtyre auditimeve ka qenë vlerësimi i pajtueshmërisë me kornizën ligjore në fuqi.
- **Auditimet me nivel të informacionit të klasifikuar** – janë përfunduar po ashtu **3 auditime** të cilat kanë përmbajtur informacion të klasifikuar dhe të njëjtat janë raportuar te personat përgjegjës në institucionet përkatëse.

#### Rezultatet kryesore nga Raporti Vjetor i Auditimit për vitin 2024

Cilësia e raportimit financiar në organizatat buxhetore vazhdon të mbetet nën nivelin e pritur. Nga 87 auditime, 46 rezultuan me keqdeklarime materiale dhe opinione të modifikuara, ndërsa vetëm 41 me opinione të pamodifikuara. Krahasuar me vitin paraprak, nuk ka përmirësim as në nivelin qendror (rritje nga 12 në 15 opinione të modifikuara) dhe as në atë lokal (nga 23 në 31). Edhe në aspektin e pajtueshmërisë me kornizën ligjore, gjendje jo e kënaqshme, pasi shumica e organizatave, veçanërisht komunat, kanë rezultuar me konkluzione të modifikuara.

Në ndërmarrjet publike, gjendja paraqitet edhe më e dobët. Nga nëntë auditime të ndërmarrjeve publike vetëm njëra ka marrë opinion të pamodifikuar, ndërsa tetë të tjerat kanë marrë opinione të modifikuara, përfshirë edhe opinione të kundërta. Kjo tregon për praninë e keqdeklarimeve materiale dhe nevojën për përmirësim të ndjeshëm të raportimit financiar. Po ashtu, të gjitha ndërmarrjet kanë shfaqur mospajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi në zhvillimin e aktiviteteve dhe transaksioneve të tyre.

Auditimet e performancës, teknologjisë së informacionit dhe pajtueshmërisë kanë identifikuar sfida të shumta në sektorë kyç publikë. Problemet përfshijnë mungesë të efikasitetit dhe efektivitetit në shërbime publike, dobësi në planifikimin e projekteve infrastrukturore, mangësi në mbrojtjen e konsumatorëve, qeverisje të dobët në ndërtim dhe zhvillim urban, si dhe menaxhim joefikas në energjinë e ripërtëritshme dhe prokurim publik. Gjithashtu, janë evidentuar dobësi në digjitalizim, siguri të informacionit dhe menaxhim të të dhënave, duke kërkuar përmirësime të konsiderueshme në qeverisje dhe llogaridhënie.

Ndikimi i auditimit vlerësohet kryesisht përmes shkallës së zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët. Kjo shërben si treguesi më i qartë për të vlerësuar nëse menaxhmenti i organizatës ka ndërmarrë veprime konkrete për të përmirësuar politikën, proceset dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm në fushat ku janë identifikuar mangësi apo parregullsi.

Auditorët përqendrohen në monitorimin e progresit, duke vlerësuar nëse çështjet e ngritura janë trajtuar në mënyrë të duhur dhe duke identifikuar përmirësimet që dëshmojnë angazhimin e menaxhmentit të entitetit të audituar.

Bazuar në rekomandimet e dhëna, këtë vit janë evidentuar përmirësime të rëndësishme në menaxhimin financiar dhe raportimin e pasurive. Bazuar në veprimet e ndërmarra, regjistrat e pasurisë janë më të saktë dhe më të plotë për vlerën rreth 177 milionë € (vlera e pasurive të regjistruara në nivel qendror ishte 125,603,346€, ndërsa në nivel lokal ishte 51,467,815€), si dhe pasqyra e pranimeve dhe pagesave është më e saktë për rreth 167 milionë €.

Këto rezultate tregojnë se rekomandimet e auditimit kanë ndikuar në përmirësimin e qeverisjes financiare dhe besueshmërisë së informacionit financiar. Procesi i auditimit ka ndikuar në rritjen e saktësisë së pasqyrave financiare përmes korigjimeve materiale në regjistrimin e pasurive, pasqyrën e pranimeve dhe pagesave, si dhe përmirësimin në zbatimin e procedurave të kontrollit të brendshëm në disa organizata buxhetore, si:

- MBPZHR-ja ka kryer vlerësimin dhe regjistrimin e 123 pronave të IBK-së, duke korigjuar pasqyrat financiare me vlera materiale;
- MSH-ja dhe MBPZHR-ja kanë bërë korigjime financiare për donacionet e kthyer në vlerë prej 5,308,000€, respektivisht korigjimin e të hyrave të realizuara nga donatorët në vlerë prej 824,999€; dhe
- SHSKUK-ja ka korigjuar gabime të mëdha në raportimin e pranimeve dhe pasurive, duke rregulluar pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave për 166,959,000€ dhe vlerën e pasurive në regjistra për 125,603,346€.

Në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë në nivel lokal, ndikim pozitiv të auditimit më të theksuar kishte Komuna e Deçanit sa i përket regjistrat të pasurisë. Komuna ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimin të regjistrat të pasurive, duke regjistruar tokat, objektet dhe parcelat në regjistrat kontabël të pasurive. Si rezultat, vlera e pasurive të regjistruara është rritur për 51,467,815€, nga 13,581,954 sa ishte në vitin 2023 në 65,049,769€ në vitin 2024. Krahas regjistrat, komuna kishte bërë edhe shpalljen e saktë të tyre në PFV.

Përveç ndikimit në aspektin financiar, ZKA-ja ka ofruar kontribut të vazhdueshëm edhe gjatë përgatitjes së draft-PFV-ve. Kjo është bërë përmes komunikimeve formale dhe takimeve direkt me përfaqësuesit e komunave, duke pasur parasysh sfidat që ata përballen në përpilimin e pasqyrave financiare. Si rezultat i këtij bashkëpunimi dhe udhëzimeve të ofruara nga ZKA-ja, është arritur një rritje e ndjeshme në cilësinë e raportimit financiar, veçanërisht në përgatitjen dhe saktësinë e dy tabelave thelbësore: 1) Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, dhe 2) Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

Në përputhje me Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm, nenin 24 dhe konform Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet ZKA-së dhe Prokurorisë së Shtetit, Departamenti për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimit në kuadër të ZKA-së, gjatë vitit 2025, ka dërguar 80 raste në Prokurorinë e Shtetit.

Këto raste janë identifikuar në raportet e auditimit, dhe kryesisht duke përfshirë procesin e prokurimit, lidhjen e kontratave, si dhe shpenzimet në kategoritë e investimeve kapitale, subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve.


### Zbatimi i rekomandimeve

Raportet e auditimit identifikojnë dobësitë në sistemet e qeverisjes, në veçanti ato financiare, ndërsa zbatimi i rekomandimeve të auditimit shërben si mekanizëm kyç për adresimin e këtyre dobësive dhe për forcimin e efikasitetit e efektivitetit të sistemeve në funksion të arritjes së objektivave institucionale. Megjithatë, analizat kanë treguar se niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të auditimit mbetet i pamjaftueshëm.


Për vitin 2023, Qeveria nuk kishte përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në nivelin e auditimeve individuale, shumica e organizatave buxhetore ende nuk kanë vendosur një proces sistematik për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit. Edhe pse krahasuar me vitin 2022 numri i rekomandimeve të dhëna në raportet individuale është zvogëluar, niveli i zbatimit të tyre mbetet i pamjaftueshëm. Vetëm 37% e rekomandimeve (duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike) janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa e mbetur është në proces zbatimi ose nuk është zbatuar akoma.

Ngecjet në zbatimin e plotë të rekomandimeve ndikojnë në vazhdimin e dobësive dhe mangësive të kontrollit, duke çuar në përsëritjen sistematike të parregullsive nga viti në vit. Niveli i zbatimit të rekomandimeve është treguesi kryesor i ndikimit të auditimit dhe reflekton nëse menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për të përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet në fushat ku janë identifikuar parregullsi. Përmes auditimeve individuale, ZKA-ja vlerëson zbatimin e rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak, duke evidentuar qartë fushat ku janë ndërmarrë masa përmirësuese dhe ato ku ende kërkohen veprime shtesë.

### Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të vitit paraprak




## Menaxhimi financiar dhe administrativ i ZKA-së, në vitin 2025



Buxheti final ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si:

- Pagat dhe shtesat në vlerë prej **2,419,717€;**
- Mallrat dhe shërbimet në vlerë prej **811,423€;**
- Shërbimet komunale në vlerë prej **40,000€** dhe
- Investimet kapitale në vlerë prej **125,175€.**



ZKA-ja ka investuar në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të personelit auditues për të siguruar që ata të jenë në hap me zhvillimet ndërkombëtare në fushën e financave, auditimit dhe fushave tjera relevante.

## Komunikimi dhe përfaqësimi me palët e jashtme

ZKA-ja në vitin 2025 ka zhvilluar komunikim efektiv me publikun si dhe ka qenë pjesë aktive në shumë takime, punëtori dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit duke kultivuar një bashkëpunim të ngushtë me partnerët si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

ZKA-ja gjatë vitit 2025 është angazhuar në mënyrë aktive në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të nxitur bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh me institucionet homologe në nivel regional dhe global. Në aspektin ndërkombëtar është avancuar bashkëpunimi me ISA-në përmes takimeve, punëtorive e aktiviteteve të tjera në kuadër të grupeve punuese dhe iniciativave të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t, ndërsa në nivel regional në kuadër të Rrjetit të ISA-ve, të vendeve kandidatë dhe kandidatëve të mundshëm për anëtarësim në BE dhe Gjykatës Evropiane të Auditorëve.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës realizohet kryesisht përmes Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere. Megjithatë, gjatë vitit 2025, për shkak të moskonstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk janë mbajtur seanca të këtyre komisioneve. Si rrjedhojë, nuk është shqyrtuar asnjë raport i auditimit nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, përfshirë raportet e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, raportet e auditimit të performancës, Raportin Vjetor të Performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe Raportin e Auditimit të Jashtëm për Pasqyrat Vjetore Financiare të saj.

## Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2025

**Sipas raportit të Barometrit Ballkanik** të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, ZKA-ja vazhdon të gëzojë nivel të lartë besimi publik, duke u vlerësuar pozitivisht për pavarësinë dhe rolin e saj në mbikëqyrjen e punës së qeverisë. Shqipëria dhe Kosova renditen ndër vendet me besimin më të lartë ndaj Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon, ku 47% e të anketuarve në Kosovë vlerësojnë se këto institucione shqyrtojnë në mënyrë efektive punën e qeverisë. Raporti gjithashtu e pozicionon Kosovën në mënyrë pozitive sa i përket perceptimit për ruajtjen e pavarësisë nga ndikimet politike.

**Sipas Raportit të Progresit 2025**, të publikuar nga Komisioni Evropian, ZKA-ja ka arritur progres të rëndësishëm në forcimin e auditimit të jashtëm, rritjen e cilësisë së auditimit dhe avancimin e transparencës dhe llogaridhënies publike në Kosovë. Raporti vlerëson përparimin në zbatimin e Planit Strategjik 2023–2026, zhvillimin e auditimeve, përfshirë ato të performancës dhe të Teknologjisë së Informacionit, si dhe përmirësimin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, duke theksuar njëkohësisht nevojën për rritjen e nivelit të zbatimit të tyre nga institucionet publike.

Këto rezultate janë një dëshmi dhe konfirmim i angazhimit të palodhur, transparencës dhe standardeve të larta etike dhe profesionale në të cilat ZKA-ja mbështet punën e saj.

## Sfidat e ZKA-së gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja është përballur me disa sfida që kanë ndikuar në funksionimin dhe zhvillimin e saj institucional. Një ndër sfidat kryesore ka qenë mungesa e një objekti adekuat për akomodimin e personelit të ZKA-së.

Edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike ka marrë vendim për ndarjen e një objekti për këtë institucion, deri më tani nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për përgatitjen dhe përshtatjen e tij për shfrytëzim nga ZKA-ja. Si pasojë, institucioni vazhdon të operojë në hapësira të marra me qira, gjë që përbën edhe kosto shtesë për buxhetin e shtetit. Një sfidë tjetër lidhet me faktin se projektligjin e propozuar Qeveria e ka vendosur në programin legjislativ për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 dhe për periudhën 2026-2028 nuk është vendosur në programin legjislativ, pavarësisht nevojës për përditësimin e kornizës ligjore të institucionit.

Po ashtu, kërkesat për realizimin e auditimeve të performancës janë në rritje të vazhdueshme, ndërkohë që pjesa më e madhe e resurseve të ZKA-së vazhdon të angazhohet në mbulimin e auditimeve mandatore të rregullsisë. Këto rrethana paraqesin sfida shtesë në planifikimin dhe balancimin e kapaciteteve për të adresuar në mënyrë efektive prioritetet e auditimit dhe kërkesave në rritje për auditime të performancës në sektorin publik.

## Baza e Raportit Vjetor të Performancës

Në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm, nenin 14 dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i dorëzon Kuvendit Raportin Vjetor të Performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Ky raport paraqet një përmbledhje të aktiviteteve dhe rezultateve kryesore të ZKA-së gjatë vitit raportues. Përmes këtij raporti informohet Kuvendi i Kosovës dhe publiku lidhur me zbatimin e mandatit kushtetues dhe ligjor të ZKA-së në auditimin e institucioneve publike. Raporti përfshin të dhëna për auditimet e realizuara, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të auditimit, si dhe progresin në zbatimin e rekomandimeve nga institucionet e audituara. Gjithashtu, në raport pasqyrohen zhvillimet institucionale, përdorimi i burimeve dhe aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve profesionale. Raporti shërben si instrument i rëndësishëm për transparencë dhe llogaridhënie ndaj Kuvendit dhe qytetarëve. Përmes tij sigurohet një pasqyrë e qartë mbi kontributin e ZKA-së në përmirësimin e menaxhimit të financave publike. Njëkohësisht, raporti ndihmon në identifikimin e sfidave dhe prioritetëve për periudhat e ardhshme. Në këtë mënyrë, Raporti Vjetor i Performancës kontribuon në forcimin e mbikëqyrjes parlamentare dhe në rritjen e transparencës në sektorin publik.

ZKA-ja ushtron mandatin e saj kushtetues dhe ligjor ndërsa vlerësimi i performancës së ZKA-së realizohet duke u bazuar në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së ISA-ve, e cila u mundëson institucioneve supreme të auditimit të matin dhe të vlerësojnë nivelin e tyre të performancës kundrejt standardeve ndërkombëtare.

Kjo kornizë ka për qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e mëtejshëm në zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve përmes menaxhimit dhe promovimit të matjes së performancës, si dhe identifikimin e mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën dhe llogaridhënien e ISA-ve.

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSAI-t, përmban gjashtë fusha kryesore siç janë:

- I. Pavarësia dhe Korniza Ligjore;
- II. Qeverisja e Brendshme dhe Etika;
- III. Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;
- IV. Menaxhimi financiar dhe administrativ;
- V. Burimet njerëzore;
- VI. Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Jashtme dhe
- VII. Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2025.

Andaj, Raporti Vjetor i Performancës së ZKA-së është hartuar dhe shpalosur në përputhje me fushat kryesore të kësaj kornize.

# 01

**Pavarësia dhe  
Korniza Ligjore**

## Kapitull I - Pavarësia dhe Korniza Ligjore

Pavarësia dhe korniza ligjore reflektojnë përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor me qëllim të kryerjes së auditimeve cilësore në përputhje me SNISA.

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor dhe pavarësinë e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm (AP)<sup>3</sup>. Përveç Kushtetutës dhe ligjeve relevante, bazë e parimeve themelore të ISA-ve për këtë fushë janë: Deklarata e Limës (INTOSAI-P 1) dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve (INTOSAI-P 10). Elementet treguese që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia institucionale dhe kompetencat.

### 1.1. Pavarësia institucionale

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Auditorin e Përgjithshëm si institucionin më të lartë të kontrollit ekonomik dhe financiar në vend. Kompetencat themelore të tij përcaktohen në Kushtetutë dhe specifikohen më tej në Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA).

Në bazë të këtij ligji, Auditori i Përgjithshëm ushtron funksionin e tij në mënyrë të pavarur, me autonomi të plotë në vendimmarrje dhe në menaxhimin e ZKA-së, duke siguruar zbatimin efektiv të mandatit kushtetues dhe ligjor. Pavarësia e tij përfshin pavarësi financiare, menaxheriale dhe administrative, si dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore për përmbushjen e detyrave.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur që mbështet Auditorin e Përgjithshëm në realizimin e funksioneve të tij.

Nëpërmjet këtij misioni, ZKA-ja synon të rritë besimin e publikut në menaxhimin e fondeve publike dhe të luajë një rol aktiv në mbrojtjen e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit.

Auditori i Përgjithshëm kryen:

- auditime të rregullsisë për Buxhetin e Kosovës, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike;
- auditime të performancës dhe forma të tjera auditimi, me qëllim vlerësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe economicitetit të aktiviteteve publike.

Në përputhje me standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t, si pjesë e Kornizës së Deklaratave Profesionale dhe Kodit të Etikës, parimi i efikasitetit në auditim nënkupton shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe lidhjen ndërmjet burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

3 Në këtë Raport, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si ZKA.

## 1.2. Mandati

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së në organizimin e brendshëm dhe ushtrimin e kompetencave të saj, në përputhje me kornizën ligjore. Vlerësimi bazohet në funksionet dhe kompetencat, qasjen në informacion, si dhe të drejtën dhe detyrimin për raportim.

Në përputhje me nenet 136 dhe 137 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm kontrollon:

- veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe subjekteve të tjera juridike shtetërore;
- përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;
- veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave të tjerë juridikë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Në bazë të mandatit ligjor, Auditori i Përgjithshëm ka të drejtë të auditojë të gjitha aktivitetet financiare, administrative dhe të tjera, programe dhe projekte të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e asetëve, privatizimeve dhe koncesioneve.

Gjithashtu, AP-ja ka qasje të pakufizuar në të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e auditimeve.

AP-ja<sup>4</sup> kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore, si dhe ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, kryen auditime të performancës ose llojeve tjera të auditimeve, për të vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe/ose ekonomikitetin e një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjeshme të ndonjë institucioni, programi ose aktiviteti.

Megjithatë, janë identifikuar disa paqartësi në legjislacionin ekzistues lidhur me auditimin e institucioneve të caktuara, për shkak të mospërputhjeve ndërmjet ligjeve të veçanta dhe dispozitave kushtetuese dhe ligjit për ZKA-në.

Gjatë periudhës së auditimit 2023–2024, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përballur me kufizime në ushtrimin e plotë të mandatit të saj kushtetues dhe ligjor në auditimin e performancës “Efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore”. Këto kufizime, të vendosura nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kanë pamundësuar realizimin e auditimit përcjellës dhe kanë penguar qasjen në informacionet dhe proceset e nevojshme për vlerësimin e plotë të performancës. Rasti është vlerësuar nga ZKA-ja si kufizim i drejtpërdrejtë i mandatit kushtetues dhe ligjor të institucionit, duke krijuar pengesë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t për auditimin e performancës.

Në përgjigje të kësaj situate, Auditorja e Përgjithshme ka ndërmarrë veprime institucionale dhe ndërkombëtare, përfshirë njoftimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe komisioneve funksionale, si dhe informimin e mekanizmave relevantë të INTOSAI-t, përfshirë Mekanizmin e Avokatisë së Shpejtë

4 Auditimet e rregullsisë sipas SNISA-ve kanë kuptimin e Auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë.

(SIRAM). Rasti është dokumentuar dhe trajtuar si kufizim i fushëveprimit të auditimit, ndërsa vlerësimi i SIRAM-it ka konfirmuar se auditimi i planifikuar bie brenda mandatit ligjor dhe kushtetues të ZKA-së, duke mbështetur qëndrimin institucional të Auditorës së Përgjithshme.

Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës i bën të zbatueshme drejtpërdrejtë standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik, si standardet e INTOSAI-t, Deklaratën e Limës 5 dhe Deklaratën e Meksikës, të cilat mbështesin kryerjen e auditimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit. AP-ja në përputhje me autorizimin kushtetues e ligjor, ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit.

Ligji aktual për ZKA-në, ndonëse garanton pavarësi funksionale dhe operacionale, nuk është plotësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, veçanërisht në aspektin e pavarësisë financiare. Në këtë drejtim, është iniciuar procesi i ndryshimit të ligjit që nga viti 2022, me qëllim harmonizimin me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit dhe rekomandimet e SIGMA-s. Projektligjin e propozuar Qeveria e ka vendosur në programin legjislativ për vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 dhe për periudhën 2026-2028 nuk është vendos në programin legjislativ.

ZKA-ja ka adresuar këtë rekomandim përmes Koncept-dokumentit për ligjin e ri për Auditorin e Përgjithshëm, duke propozuar rishikimin e mandatit të detyrueshëm të auditimeve me qëllim rritjen e fleksibilitetit në planifikim dhe realizimin e auditimeve të bazuara në rrezik.

Projektligji i ri synon të adresojë çështjet kyçe, duke përfshirë:

- përkufizimin e qartë të llojeve të auditimeve;
- rritjen e fleksibilitetit për përzgjedhjen e auditimeve bazuar në rrezik;
- forcimin e pavarësisë financiare, funksionale dhe organizative;
- përcaktimin e statusit unik të personelit;
- garantimin e imunitetit funksional;
- përmirësimin e mekanizmave për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditori i Përgjithshëm raporton në mënyrë të pavarur në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke prezantuar Raportin Vjetor të Auditimit dhe duke kontribuar në rritjen e llogaridhënies së institucioneve publike. Të gjitha raportet e auditimit publikohen për të siguruar transparencë të plotë me përjashtim të raporteve që përmbajnë informata të klasifikuara.

Mbi këtë bazë, ka ftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës që të kërkojë rritjen e përgjegjësisë llogaridhënëse nga institucionet e audituara në mënyrë që të ndërmerren veprime të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve dhe adresimin e mangësive të raportuara.

5 Në bazë të praktikave të mira ndërkombëtare (Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e ISA-ve) për të siguruar pavarësinë e plotë financiare, rekomandohet që buxheti i ISA-ve të trajtohet nga Kuvendi, jo nga Qeveria.

# 02

**Qeverisja e  
brendshme dhe etika**

## Kapitull II - Qeverisja e brendshme dhe etika

Qeverisja e brendshme dhe etika, përfshijnë treguesit si:


- Planin strategjik, operativ dhe planin vjetor;
- Mjedisin e kontrollit organizativ; dhe
- Komunikimin e brendshëm.

### 2.1. Plani strategjik, operativ dhe plani vjetor

ZKA-ja zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në planin strategjik, planin operativ dhe planin vjetor të auditimit.

- **Plani strategjik** - Dokumenti i miratuar për periudhën 2023-2026 është në vitin e tretë të zbatimit. Rezultatet e arritura do të identifikohen përmes planit operativ, i cili shërben si një mjet për të monitoruar realizimin e objektivave strategjike dhe raportuar avancimin e Planit Strategjik. ZKA-ja - Departamenti për Planifikim Strategjik ka përgatitur raporte gjashtëmujore dhe raporte vjetore mbi zbatimin e planit të veprimit dhe monitorimit të strategjisë së ZKA-së. Gjatë kësaj periudhe 2023 - 2026, ZKA-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve strategjike, përfshirë: realizimin e misionit të saj kushtetues dhe ligjor përmes kryerjes së auditimeve të rëndësishme në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, rritjen e kapaciteteve institucionale për të siguruar auditime efektive, si dhe përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit.
- **Plani i veprimit** - ZKA-ja ka vazhduar me përmbushjen e objektivave strategjike në përputhje me planin operativ. Progresi në arritjen e objektivave strategjike deri në vitin 2025 është si vijon: nga gjithsej 60 aktivitete të planifikuara, 41 aktivitete ose 68.33%, janë realizuar plotësisht, 11 aktivitete ose 18.33%, janë realizuar pjesërisht ose janë në proces zbatimi, tetë aktivitete ose 14.33%, nuk janë realizuar. Mospërmbushja e aktiviteteve është për shkak të nevojës për bashkëpunim me palët e jashtme, miratimit të ligjit të ZKA-së dhe mekanizmit që përfshin shqyrtimin e raporteve të auditimit të ZKA-së gjatë dëgjimeve buxhetore të organizatave në procesin e hartimit të ligjit për buxhetin. Krijimi i boshllëkut në kuvend për vitin 2025 ka ndikuar drejtpërdrejt në mosarritjen e plotë të objektivave nga plani strategjik.

#### 60 aktivitete të planifikuara



- **Plani vjetor i auditimit** - AP-ja ka miratuar Planin Vjetor të Auditimit 2025/2026, i cili përfshin sezonin e auditimit nga 1 shtatori 2025 deri 31 gusht 2026. ZKA-ja përgatit çdo vit këtë plan, i cili ofron informacione mbi objektivat e saj, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, organizimin, buxhetin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore, si dhe auditimet e projekteve. Gjatë përgatitjes së Planit Vjetor të Auditimit, janë marrë parasysh: përmbushja e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë), mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës, pajtueshmërisë dhe rëndësia e çështjeve aktuale. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh kapacitetet njerëzore dhe financiare që ZKA-ja ka pasur në dispozicion. Në përputhje me kërkesat ligjore, plani është dorëzuar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere më 30 tetor 2025.

## 2.2. Mjedisi i kontrollit organizativ

Në përputhje me kërkesat e ligjit, rregulloreve të brendshme dhe SNISA-ve, ZKA-ja ka ndërtuar një strukturë organizative të përshtatshme, e cila mbështet krijimin e një sistemi të kontrollit të brendshëm. Ky sistem ofron një siguri të arsyeshme se operacionet e institucionit menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase.

- **Kodi i Etikës së ZKA-së** - Forcimi i integritetit institucional mbetet një ndër prioritetet kryesore të ZKA-së. Në këtë kuadër, është përditësuar Kodi i Etikës, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit (ISA dhe INTOSAI), duke synuar rritjen e standardeve të sjelljes profesionale.

Kodi bazohet në pesë parime themelore siç janë:

- Integriteti;
- Pavarësia dhe objektiviteti;
- Kompetenca profesionale;
- Sjellja profesionale;
- Konfidencialiteti dhe transparenca.

Për të rritur llogaridhënien, Kodi përfshin katër deklaratat të detyrueshme, siç janë:

- Deklarata për pranimin e Kodit të Etikës;
- Deklarata për konfliktin e interesit dhe konfidencialitetin;
- Deklarata e pavarësisë profesionale;
- Deklarata për punësimin e anëtarëve të familjes.

Ky kod përcakton qartë përgjegjësitë individuale dhe institucionale, si dhe përfshin një kapitull të veçantë për konfliktin e interesit, duke sqaruar procedurat e raportimit, ndalimet dhe masat disiplinore.

Kodi tashmë përfshin një kapitull të veçantë dhe të detajuar për konfliktin e interesit, duke sqaruar rastet, procedurat e raportimit, ndalimet, detyrimet e transparencës dhe masat disiplinore.

Gjithashtu, Kodi përcakton funksionimin e Komisionit të Etikës, i cili vazhdon veprimtarinë e tij në bazë të vendimit nr. 39, datës 14.01.2026, si dhe rregullon detyrat, përbërjen e komisionit, procesverbalin, vendimmarrjen, afatet për shqyrtim, të drejtën e ankimit, bashkëpunimin, këshillimin, interpretimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Etikës.

Bazuar në këtë Kod, Komisioni promovon etikën dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të punësuarit e ZKA-së për rregullat etike. Komisioni mund të organizojë seminare, trajnime, dhe aktivitete edukative për të ndihmuar personelin që të kuptojnë më mirë dhe të respektojnë politikën etike. Kjo ndihmon për të krijuar një kulturë të përgjegjshmërisë dhe integritetit brenda organizatës.

Në përputhje me planin e trajnimeve 2025–2026, janë organizuar trajnime për Kodin e Etikës dhe konfliktin e interesit për të gjithë personelin, të cilat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, me qëllim forcimin e kulturës së integritetit dhe profesionalizmit në institucion.

- **Sistemi i kontrollit të brendshëm** - Kontrolli i brendshëm për aktivitetet joaudituese kryhet nëpërmjet rregullave dhe procedurave të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në ZKA zbatohet: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm. ZKA-ja ka përgatitur një dokument të dedikuar për menaxhimin e rreziqeve, i cili zbatohet duke u mbështetur në objektivat e përcaktuara në dokumentet e saj strategjike dhe në kornizën e aplikueshme për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Gjithashtu, ZKA-ja ka zhvilluar një strukturë funksionale të mirë të kontrolleve të brendshme. Të gjithë komponentët e këtyre kontrolleve veprojnë në mënyrë efektive, duke përfshirë edhe procesin e vlerësimit të rreziqeve.
- **Auditimi i Brendshëm** - Në kuadër të strukturës organizative të ZKA-së funksionon NJAB-ja. Auditori i Brendshëm i raporton drejtpërdrejt Auditorit të Përgjithshëm. Planifikimi i aktiviteteve të AB-së bazohet në metodologjinë e bazuar në rrezik, me qëllim të ofrimit të sigurisë për AP-në lidhur me efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm në ZKA.

Gjatë vitit 2025, AB ka dorëzuar katër raporte auditimi, të cilat kanë trajtuar temat: “Menaxhimi i Shërbimeve të Përkthimit në ZKA”, “Menaxhimi i Procesit të Vlerësimit të rezultateve në Punë”, “Menaxhimi i Shpenzimeve dhe procesi i buxhetimit në ZKA” dhe “Aktivitetet e Prokurimit”.

Në mbështetje të sistemit të qeverisjes institucionale funksionon edhe Komiteti i Auditimit, i cili ushtron rolin e tij në përputhje me rregullativën në fuqi. Gjatë vitit 2025, KA ka mbajtur katër takime dhe ka hartuar raportin vjetor të punës. Në këto takime janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm dhe çështje tjera që ndërlidhen me fushëveprimin e tij, me qëllim të mbështetjes së AP-së në forcimin e kontrollit të brendshëm, menaxhimit të rrezikut dhe qeverisjes në ZKA.

## 2.3. Komunikimi i brendshëm

Komunikimi i brendshëm efektiv u ndihmon punonjësve të ZKA-së që të bashkërendojnë punët dhe kërkesat që lidhen me auditimet dhe çështjet administrative brenda institucionit. Menaxhmenti i ZKA-së mban takime javore, ku diskutohen çështjet kryesore. Për këto takime përgatiten procesverbale dhe vendimet e marra u dërgohen punonjësve sipas rëndësisë. Dokumentet janë të qasshme për të gjithë personelin. Përveç kësaj, përmes rrjetit të brendshëm të komunikimit elektronik, menaxhmenti e informon rregullisht personelin për zhvillimet që kanë të bëjnë me institucionin.

Niveli i mesëm drejtues raporton rregullisht për punën e bërë. Procesi i auditimit dokumentohet përmes dosjeve përkatëse dhe përmes sistemit SITA, gjë që ka ndihmuar në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së punës.

Në qershor 2024 është miratuar Udhëzuesi për Komunikim në Zyrën Kombëtare të Auditimit, i cili ka për qëllim të sigurojë që komunikimi brenda institucionit të jetë i qartë, i koordinuar dhe i menaxhuar mirë. Ky udhëzues ndihmon në promovimin e misionit, vizionit dhe vlerave të ZKA-së.

Përveç takimeve javore, drejtuesit e auditimit dhe drejtuesit e departamenteve mbështetëse mbajnë edhe takime mujore. Edhe këto takime dokumentohen me procesverbale dhe nga to dalin konkluzione të rëndësishme që ndihmojnë në konsistencën dhe koordinimin e punës.



# 03

**Fushëveprimi,  
Cilësia e Auditimit  
dhe Raportimi**

## Kapitulli III – Fushëveprimi, Cilësia e Auditimit dhe Raportimi

Komponentët që trajtohen në këtë kapitull janë: planifikimi, realizimi dhe cilësia e auditimeve, raportimi i rezultateve të auditimeve, adresimi i rekomandimeve nga subjektet e audituara, si dhe kontrolli i cilësisë.

### 3.1. Cilësia e auditimit dhe raportimi

ZKA-ja kryen auditimet në pajtueshmëri me SNISA-t dhe praktikat e mira. Po ashtu, për të siguruar cilësinë e auditimeve ka të hartuar: doracakun e auditimit financiar, me qasje të kombinuara të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë; doracakun e auditimit të pajtueshmërisë; doracakun për auditime të performancës dhe prokurimit; si dhe doracakun e auditimit të teknologjisë së informacionit. Për të siguruar përfundimin e duhur të procesit të llogaridhënies për cilësinë në auditim, janë hartuar edhe udhëzuesit e rinj për menaxhimin e cilësisë.

Në përputhje me mandatin ligjor dhe fushëveprimin, ZKA-ja kryen këto lloje të auditimeve:

- Auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike;
- Auditime të performancës, përfshirë auditimin e teknologjisë së informacionit; dhe
- Auditime të pajtueshmërisë.
- **Auditimi Financiar dhe i Pajtueshmërisë** - përfshin auditimin e PFV-ve të institucionit me qëllim të vlerësimit nëse:
  - raportet financiare janë të besueshme dhe pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë;
  - menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; dhe
  - sistemi i menaxhimit financiar, auditimi i brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar.

Objektivi i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë është që t'u ofrojë shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, siguri të arsyeshme nëse informacioni i prezantuar në pasqyrat financiare të audituara është, në kuptimin material, i drejtë dhe i vërtetë dhe të drejta dhe nëse transaksionet e raportuara në ato pasqyra janë kryer në pajtueshmëri me autoritetet<sup>6</sup>.

Qëllimi gjithëpërfshirës i auditimit financiar dhe i pajtueshmërisë është të rritet niveli i besueshmërisë së përdoruesve të synuar të Pasqyrave Financiare Vjetore dhe përdorimi i fondeve publike në pajtueshmëri me autoritetet.

<sup>6</sup> "Pajtueshmëri me autoritetet" do të thotë është pajtueshmëri me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira.

Auditimet financiare dhe pajtueshmërisë kryhen çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor të vitit pasues. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

- **Auditimet e performancës** - paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (*minimizimi i kostove të burimeve*), efikasitetit (*përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion*) dhe efektivitetit (*përmbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara*). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një tërësi nga tri qasjet: qasjen e orientuar në rezultate, qasjen e orientuar në problem dhe qasjen e orientuar në sistem, ose një kombinim të qasjeve.

Auditimet e teknologjisë së informacionit - pasqyrojnë vlerësimin dhe rishikimin e sistemeve të TI-së dhe kontrollet e ndërlydhura me to, për të përfutur siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së.

- **Auditimet e pajtueshmërisë** - janë vlerësime të pavarura nëse lënda e caktuar është në pajtueshmëri me autoritetet e zbatueshme, të identifikuar si kritere. Auditimet e pajtueshmërisë kryhen duke vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni janë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me autoritetet që rregullojnë entitetin e audituar<sup>7</sup>.

## 3.2. Auditimet e realizuara në vitin 2025

Auditimi financiar dhe i pajtueshmërisë për organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike për vitin financiar 2024 ka filluar në shtator 2024. Në dhjetor të po atij viti janë përgatitur memorandumet e planifikimit të auditimit për secilën organizatë, ndërsa raportet përfundimtare të auditimit janë publikuar në qershor të vitit 2025. Raporti Vjetor i Auditimit është finalizuar në gusht të vitit 2025, duke shënuar mbylljen e sezonit të auditimit.

Në shtator të vitit 2025 ka nisur sezoni i ri i auditimit për vitin financiar 2025. Edhe në këtë sezon, memorandumet e planifikimit të auditimit janë përgatitur në dhjetor të vitit 2025, ndërsa raportet përfundimtare do të publikohen në qershor dhe gusht të vitit 2026.

Përveç këtyre, ZKA-ja realizon edhe auditime të performancës dhe auditime të pajtueshmërisë, të cilat zhvillohen gjatë tërë vitit dhe nuk janë të lidhura me afate të përcaktuara sezonale si auditimet financiare. Këto auditime kërkojnë planifikim dhe kohëzgjatje fleksibile, në varësi të fushës dhe kompleksitetit të auditimit, dhe për këtë arsye shtrihen përgjatë gjithë vitit kalendarik.

Pikërisht për shkak të këtyre dallimeve kohore ndërmjet ciklit të auditimeve financiare dhe natyrës së auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë, në renditjen e prezantimit të të dhënave brenda Raportit Vjetor të Performancës është vendosur që së pari të paraqitet realizimi i arritur gjatë vitit 2025, e më pas të prezantohen planifikimet për dy sezonet përkatëse të auditimit. Kjo qasje siguron qartësi kronologjike, shmang konfuzionin midis të dhënave të realizuara dhe planeve vjetore, dhe i ndihmon lexuesit të kuptojnë qartë lidhjen ndërmjet performancës së raportuar dhe planifikimeve për sezonin e ri të auditimit.

Tabela 1. Numri dhe llojet e auditimeve të realizuara në vitin 2025

Llojet e auditimeve	Auditimet e realizuara
	2025
Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	104
Buxheti i Kosovës	1
Institucionet qendrore	49
Komunat	38
Ndërmarrjet publike	9
Projektet	7
Auditimet e performancës	14
Performancë	11
Teknologji informative	3
Auditime të pajtueshmërisë	12
Auditime me nivel të informacionit të klasifikuar	3
Gjithsej	133

ZKA-ja ka përmbushur mandatin duke mbuluar me auditime financiare dhe të pajtueshmërisë të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë RTK-në e cila ka status të veçantë por që financohet përmes buxhetit të Kosovës, si edhe me auditime të performancës dhe të pajtueshmërisë.

ZKA-ja ka planifikuar të kryejë 12 auditime financiare dhe të pajtueshmërisë në ndërmarrjet publike, ndërsa ka realizuar nëntë prej tyre. Nga këto 12 auditime, tre lidhen me auditimet e pasqyrave për qëllime të veçanta në KEK dhe KOSTT. Megjithatë ishte planifikuar që ZKA-ja t'i kryente këto auditime, KEK-u në mënyrë të njëanshme ka kontraktuar një kompani private në janar 2025, edhe pse paraprakisht ishte njoftuar se ZKA-ja do të kryente auditimin financiar, të pajtueshmërisë dhe auditimet e pasqyrave për qëllime të veçanta. Për të shmangur punën e dyfishtë, ZKA-ja është tërhequr nga dy auditimet e pasqyrave për qëllime të veçanta në KEK.

Sa i përket KOSTT-it, kjo ndërmarrje kishte një kontratë paraprake me një kompani private të auditimit. Megjithëse ZKA-ja e kishte njoftuar se auditimi ishte përfshirë në planin vjetor, përgjigjja e tyre ishte pozitive dhe shprehën gatishmëri për të parë mundësinë e realizimit. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur. Prandaj, për të shmangur dyfishimin e punës dhe të opinioneve, ZKA-ja është tërhequr edhe nga ky auditim për këtë sezon.

Qëllimi i ZKA-së është që në të ardhmen të krijohet një bashkëpunim i mirë, ku auditimet të kryhen nga ZKA-ja, duke shmangur kontraktimet paralele me kompani private dhe duke siguruar kosto më të favorshme për ndërmarrjet publike.

### 3.3. Auditimet e planifikuara

Tabela 2. Numri dhe llojet e auditimeve të planifikuara për sezonin auditues 2024/2025

Llojet e auditimeve	Sezoni i auditimit/plani vjetor	
	2025/2026	2024/2025
Auditime të rregullsisë	106	108
Buxheti i Kosovës	1	1
Institucionet Qendrore	49 <sup>8</sup>	49
Komunat	38	38
Ndërmarrjet Publike	12	12
Projektet	6	8
Auditimet e performancës	23	17
Performancë	16	5
Prokurim <sup>9</sup>	0	5
Teknologji Informative	4	3
Performancë - vazhdim nga viti paraprak	3	4
Auditime të pajtueshmërisë	13	11
Pajtueshmëri - vazhdim nga viti paraprak	3	0
Pajtueshmëri	10	11
Auditime të klasifikuara	3	3
Klasifikuara	3	3
Gjithsej	145	139

8 Është themeluar Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar.

9 Pjesa e prokurimit nga ky vit është e integruar në kuadër të auditimeve të performancës.

Për sezonin auditues 2025/26, përveç auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë (auditime mandatore) të 87 OB-ve (plus auditimin e RVA-së), ishin planifikuar 12 auditime të NP-ve, si dhe gjashtë auditime të projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Përveç auditimeve të detyrueshme të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë) të përcaktuara me ligj, fokus i veçantë ishte planifikuar t'u jepej ndërmarrjeve publike që ishin vlerësuar si më komplekse, siç ishin: KEK-u, Trepça, KOSTT-i, Termokosi etj, dhe projekteve kapitale të financuara nga donatorët.

Gjatë vitit të kaluar, ZKA-ja kishte kontraktuar gjithsej 22 auditime për t'u kryer nga kompania private e auditimit. Këtë vit, numri i auditimeve të kontraktuara është reduktuar në 20, të ndara në 10 institucione të pavarura dhe 10 komuna. Ky reduktim prej dy auditimesh pasqyron një rishikim të planifikimit vjetor me synim optimizimin e përdorimit të mbështetjes së jashtme dhe rritjen e efikasitetit në procesin e auditimit.

Pavarësisht këtij ndryshimi, qasja profesionale mbetet e pandryshuar: auditimet do të realizohen nga kompania private e auditimit, ndërsa opinioni i auditimit do të përcaktohet nga Auditori i Përgjithshëm, duke u bazuar në metodologjinë e ZKA-së dhe në përputhje me kërkesat e SNISA-ve. Kjo siguron cilësi, koherencë dhe standard të lartë profesional në raportimin përfundimtar.

Kontraktimi i auditimeve ishte planifikuar si masë për adresimin e largimit (dorëheqjeve) të personelit profesionist nga puna, kryesisht për shkak të pagave jokonkurrese për këtë profesion. Po ashtu, ishin planifikuar masa për fokusimin e kapaciteteve njerëzore në dispozicion në fushat me rrezik të lartë. Gjatë këtij viti, ishin planifikuar gjithsej 11 auditime të pajtueshmërisë, duke reflektuar rritjen e vëllimit të punës për burimet në dispozicion.

Vlen të theksohet se ZKA-ja kishte planifikuar dhe krijuar mekanizma të brendshëm për trajtimin e kërkesave të ndryshme që vinin nga palët e jashtme për auditime me kërkesë, të cilat ishin planifikuar të trajtoheshin në mënyrën më efektive.

### 3.4. Rezultatet e auditimit dhe adresimi i rekomandimeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë

Raporti Vjetor i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës të vitit 2024 është dorëzuar në Kuvendin e Kosovës brenda afatit ligjor në gusht të vitit 2025.

1. Përmbledhje e mangësive të identifikuara në raportet e auditimit për vitin 2024 dhe të publikuara në vitin 2025
  - **Organizatave buxhetore**- Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur për shkak se nga 87 auditimet e pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore 46 prej tyre kishin keqdeklarime materiale, të cilat kanë rezultuar me opinion të modifikuar. Ndërsa, 41 të tjera kanë rezultuar me opinion të pamodifikuar.

Duhet theksuar se në nivelin qendror në lidhje me raportimin financiar gjendja me vitin paraprak nuk tregon përmirësim. Në vitin 2024 te niveli qendror, janë 15 OB me opinione të modifikuara ndërsa në vitin 2023 ishin 12 me opinione të modifikuara. Në nivelin lokal në vitin 2024 janë dhënë 31 opinione të modifikuara që krahasuar me vitin 2023 ishin 23 opinione të modifikuara. Kjo tregon një gjendje jo të mirë sa i përket raportimit financiar.

Për sa i përket pajtueshmërisë së aktiviteteve dhe transaksioneve me kornizën ligjore, gjendja ishte jo e mirë sidomos te niveli lokal. Në vitin 2024, nga 87 organizatat buxhetore të audituara 33 kishin konkluzion të pamodifikuar kurse 54 e kishin konkluzionin e modifikuar, prej tyre 37 komuna dhe 17 organizata të nivelit qendror. Në raport me vitin paraprak nuk vërehet ndonjë përmirësim.

- **Ndërmarrjet Publike** - Cilësia e raportimit financiar ende vazhdon të mos jetë në nivelin e pritur. Nga nëntë auditimet e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, vetëm për një ndërmarrje është dhënë opinion i pamodifikuar, ndërsa për tetë të tjera opinion i modifikuar prej tyre katër opinione të kualifikuara dhe katër të kundërta. Cilësia e raportimit financiar në ndërmarrjet publike ka nevojë për përmirësime të mëtejme, duke marrë parasysh se në tetë prej tyre pasqyrat financiare për vitin 2024 përmbanin keqdeklarime materiale. Po ashtu, sa i përket pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të gjitha ndërmarrjet e audituara kishin kryer transaksionet dhe aktivitetet jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- **Zbatimi i rekomandimeve** - Raportet e auditimit për vitin 2024 kanë rezultuar gjithsej me 681 gjetje dhe rekomandime për adresimin e tyre. Prej tyre 548 rekomandime janë dhënë për OB-të mandatore (*niveli qendror, niveli lokal dhe institucione të pavarura*), ndërsa 133 janë për ndërmarrje publike.
- **Konkluzioni i përgjithshëm** është se ndikimi i punës së ZKA-së ishte përmirësimi i menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike me efekt pozitiv në disa fusha. Përmirësimet janë vërejtur te cilësia e raportimit financiar, regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë publike, dhe te regjistrimi i drejtë i detyrimeve kontingjente. Te ndërmarrjet publike zbatimi i rekomandimeve ka pasur ndikim pozitiv në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin vjetor brenda afatit kohor, prezantimin e saktë të detyrimeve kontingjente, përditësimin e kontratave të punës, hartimin e rregulloreve të brendshme për menaxhimin e aktiviteteve në ndërmarrje etj. ZKA-ja ka audituar 87 OB dhe nëntë ndërmarrje publike për vitin fiskal 2024. Rezultati përcjellës dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve është paraqitur më poshtë:

Tabela 3. Progresi i zbatimit të rekomandimeve në vitin 2024 nga viti paraprak në OB dhe NP

Subjektet e audituara	Nr. i rekomandimeve në 2023 (Nr.)	Rekomandimet që nuk janë të aplikueshme më (Nr.)	Rekomandimet për zbatim (Nr.)	Të zbatuara me %	Pjesërisht të zbatuara me %	Të pazbatuara me %
Institucionet e nivelit qendror	127	4	123	52 42%	11 9%	60 49%
Institucionet e pavarura	52	7	45	25 56%	7 15%	13 29%
Institucionet e nivelit lokal	369	15	354	130 37%	20 5%	204 58%
Ndërmarrjet Publike	133	27	106	27 25%	8 8%	71 67%
Gjithsej rekomandimet	681	53	628	234 37%	46 7%	348 56%

Nga gjithsej 681 rekomandime të dhëna në vitin 2023, pas përjashtimit të 53 rekomandimeve që nuk janë më të aplikueshme, kanë mbetur 628 rekomandime për zbatim. Nga këto, 37% janë zbatuar plotësisht, 7% janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 56% mbeten të pazbatuara. Këto të dhëna tregojnë se niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve mbetet relativisht i ulët dhe se më shumë se gjysma e rekomandimeve ende nuk janë adresuar nga institucionet e audituara.

Sipas kategorive të institucioneve, institucionet e pavarura kanë shënuar nivelin më të lartë të zbatimit të rekomandimeve (56%), të ndjekura nga institucionet e nivelit qendror me 42% dhe institucionet e nivelit lokal me 37%<sup>10</sup>.

Ndërkohë, ndërmarrjet publike paraqesin performancën më të dobët, me vetëm 25% të rekomandimeve të zbatuara dhe 67% të pazbatuara, duke reflektuar sfida më të theksuara në adresimin e rekomandimeve të auditimit.

Në auditimet e performancës gjatë vitit 2025 janë dhënë 117 rekomandime, ndërsa niveli i zbatimit të tyre bëhet pas një periudhe më të gjatë kohore 4-5 vite.

10 Ky numër i zbatimit të rekomandimeve i takon auditimeve financiare dhe pajtueshmërisë

## 3.5. Auditimet e performancës

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2025 ka kryer 14 auditime të performancës dhe teknologjisë së informacionit. Këto auditime kanë mbuluar fusha me interes për qytetarët, Kuvendin e Kosovës dhe palët e tjera të interesit, me fokus në fusha si: sociale, shëndetësi, zhvillim ekonomik dhe buxhet, prokurim publik si dhe teknologji të informacionit.

### Mirëqenie ekonomike/sociale



1. Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë
2. Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e lejeve të ndërtimit në Komunën e Fushë Kosovës
3. Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës

### Arsim/Sociale



1. Funksionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore

### Mjedisi



1. Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore

### Përcjellje e rekomandimeve



1. Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit (2019)
2. Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK-në dhe GPK-në për vitin 2021”

### Prokurim publik



1. Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë
2. Efikasiteti në planifikimin dhe menaxhimin e projektit “Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës”
3. Efikasiteti në realizimin e projektit “Rehabilitimi i Linjës 10 Hekurudhore Hani i Elezit – Leshak”



## Energji

1. Menaxhim i Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë

## Teknologji e Informacionit



1. Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së të dhënave dhe implementimi i inteligjencës së biznesit
2. Platforma e shërbimeve online e-Kosova
3. Sistemi i Tatimit në Pronë – SITP

Në këto auditime ZKA-ja ka përfshirë 30 organizata, prej tyre 13 ministri, 10 komuna, tri agjenci, një ndërmarrje publike, si dhe tri organizata tjera. Për organizatat e audituara janë dhënë 117 rekomandime.

### 1. Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë.

- **Entiteti nën auditim:** Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- **Mesazhi i auditimit:** Sistemi aktual për mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i koordinuar mirë, dhe paraqet dobësi të theksuara në secilën hallkë të tij. Procedurat për trajtimin e ankesave nuk janë të qasshme, të unifikuara dhe nuk monitorohen në mënyrë sistematike e të verifikueshme, gjë që e bën të pamundur sigurimin e një mbikëqyrjeje të besueshme dhe transparente për ecurinë dhe zgjidhjen e rasteve. Inspektimet në terren kryhen kryesisht pas ankesave individuale dhe jo në bazë të analizës së rrezikut. Kjo qasje pengon mbulimin në kohë të sektorëve me rrezik të lartë, si tregtia elektronike. Strategjitë dhe planet për mbrojtje të konsumatorëve nuk përcillen me veprime konkrete e të matshme, ndërsa fushatat për ndërgjegjësim janë të kufizuara dhe nuk arrijnë te të gjithë qytetarët. Këto dobësi ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e mbrojtjes, ku janë dhënë 13 rekomandime.

### 2. Funkionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore

- **Entitetet nën auditim:** Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit. Komunitetet Prishtinë, Prizren dhe Gjakovë.
- **Mesazhi i auditimit:** Pavarësisht iniciativave ligjore dhe përpjekjeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për të avancuar edukimin në fëmijërinë e hershme, sistemi ekzistues përballet me sfida të theksuara në aspektin strukturor, menaxherial dhe zbatues. Mungesa e infrastrukturës ligjore sekondare, si dhe e mekanizmave funksional për monitorim, licencim dhe inspektim të institucioneve parashkollore, pamundëson zbatimin efektiv të politikave arsimore në këtë sektor. Në nivel lokal, ndonëse janë evidentuar disa përparime në ndërtimin e objekteve të reja parashkollore dhe në realizimin e monitorimeve të pjesshme, mungesa e planeve zhvillimore afatgjata, rregulloreve të brendshme të funksionimit dhe përfshirja e pamjaftueshme e të gjitha grupmohave e pengojnë ndjeshëm sigurimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor të edukimit parashkollor. Për përmirësimin e gjendjes, janë dhënë gjithsej tetë rekomandime.

### 3. Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore

- **Entitetet nën auditim:** Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.
- **Mesazhi i auditimit:** Institucionet përgjegjëse si: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, nuk kanë arritur të menaxhojnë në mënyrë të duhur hapësirat pyjore të vendit. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka arritur të përgatitë dhe të miratojë udhëzimet administrative të nevojshme për menaxhimin e pyjeve. Si rezultat, Agjencia Pyjore e Kosovës operon pa kornizë të plotë rregullative për disa nga funksionet e saj thelbësore, përfshirë: inventarizimin e pyjeve, hartimin e planeve për rikultivim etj.

Mungesa e kontrollit efektiv nga Inspektorati ka kontribuar në keqpërdorimin e pyjeve dhe në dëmtimin e pronës publike. Parqet Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri” vazhdojnë të përballen me sfida serioze, përfshirë prerjet ilegale dhe ndërtimet pa leje, duke shkaktuar përkeqësim të gjendjes në zonat e mbrojtura. Gjithashtu, mungesa e unifikimit të emërtimeve të pronave evidentojnë dobësi të theksuara në sistemin e kontrollit dhe administrimit të pronave pyjore publike. Për përmirësimin e gjendjes kemi dhënë 11 rekomandime.

### 4. Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit (2019)

- **Entitetet nën auditim:** Ministri, Agjenci vartëse, Komuna, Ndërmarrje Publike.
- **Mesazhi i auditimit:** Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës reflekton një mungesë të angazhimit institucional dhe llogaridhënie të dobët. Nga 199 rekomandime të dhëna, vetëm 51 rekomandime janë zbatuar apo 25%, ndërsa 111 apo 55% e rekomandimeve nuk kanë filluar ende zbatimin. Për 31 rekomandime apo 16% të tyre nuk ka qenë e mundur të bëhet vlerësimi për shkak të mungesës së përgjigjeve nga subjektet e audituara respektivisht kufizimit të fushëveprimit, ndërsa gjashtë rekomandime apo 4 % janë në proces të zbatimit. Kjo gjendje ngrit shqetësime në lidhje me efikasitetin e procesit të auditimit dhe ndikimin e tij real në menaxhimin publik ku janë dhënë tre rekomandime për Kuvendin dhe Qeverinë.

### 5. Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e lejeve të ndërtimit në Komunën e Fushë Kosovës

- **Entiteti nën auditim:** Komuna e Fushë Kosovës
- **Mesazhi i auditimit:** Komuna e Fushë Kosovës nuk ishte treguar efikase dhe efektive në sigurimin e përputhshmërisë së ndërtimeve të larta banesore me planifikimet hapësinore dhe kërkesat e procesit ndërtimor. Mungesa e dokumenteve bazë të planifikimit, si Plani Zhvillimor Komunal dhe planet rregulluese të hollësishme, si dhe dobësitë në menaxhimin e procesit nga kushtet ndërtimore deri te certifikata e përdorimit, përfshirë numrin e ulët të inspektimeve dhe kontrollet e pamjaftueshme, kanë bërë që ndërtimet të zhvillohen pa harmonizim të plotë me standardet dhe kërkesat ligjore. Kjo gjendje rrit rrezikun për zhvillim urban të paqëndrueshëm dhe për përdorim të objekteve pa u siguruar plotësisht për përputhshmërinë dhe sigurinë e tyre, ku janë dhënë 10 rekomandime.

### 6. Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës

- **Entiteti nën auditim:** Komuna e Prishtinës
- **Mesazhi i auditimit:** Komuna e Prishtinës nuk ishte efikase as efektive në procese nga lëshimi i lejeve të ndërtimit deri te pajisja me certifikata të përdorimit. Ka mungesë të kontrolleve gjatë lëshimit të kushteve, trajtim jo të barabartë të kërkesave për leje ndërtimore, mungesë të inspektimeve të mirëfillta dhe të rregullta si dhe mekanizmi për pajisje me certifikatë të përdorimit nuk është efektiv.

Vetëm 15% e lejeve të lëshuara për ndërtim gjatë viteve 2017- 2021 janë pajisur me certifikatë të përdorimit, pra, pjesa tjetër e ndërtesave nuk u ofron qytetarëve apo banorëve siguri që objektet janë të sigurta dhe përmbushin standardet e parapara për të jetuar, e për më tepër, as nuk u sigurohet e drejta ligjore mbi atë pronë. Rritja e sipërfaqes ndërtimore në leje krahasuar me kushtet ndërtimore është tetë deri në 56%, rrjedhimisht ndërtesat janë tri-katër kate më të larta se sa janë paraparë në plane urbane.

Vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore sillen në mes tre dhe 30 muaj, shkaktuar kjo nga shpërndarja jo e duhur e detyrave të zyrtarët përgjegjës, ku një zyrtari i është deleguar trajtimi i 97 lejeve të ndërtimit, ndërsa një tjetri vetëm dy. As shpërndarja e inspektimeve tek inspektorët nuk është proporcionale sepse vetëm një inspektori i janë ndarë 54% e lëndëve që ne kishim mostër, ndërsa nëntë inspektorëve tjerë pjesa e mbetur. Vonesat në përgjigje ndaj kërkesave të investitorëve për inspektim janë nga tetë deri në 60 ditë, gjë që ka ndikuar edhe në uljen dhe vullnetin e investitorëve për të bërë kërkesë për inspektim. Komunës i janë dhënë shtatë rekomandime.

## 7. Efikasiteti i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës në ndërtimin e objektit të Klinikës së Ortopedisë

- **Entitetet nën auditim:** Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës si dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës.
- **Mesazhi i auditimit:** SHSKUK-ja nuk ishte efikase në menaxhimin e projektit për ndërtimin e klinikës së Ortopedisë për arsye se planifikimin dhe menaxhimin nuk e kishte bërë si duhet. Për pasojë realizimi dhe futja në funksion e saj kishte marrë kohë më tepër se sa që ishte planifikuar, si dhe shpenzimet e realizuara kishin tejkaluar ato të planifikuara. Me fjalë tjera, përveç që përmirësimi i kushteve të klinikës për trajtim të pacienteve është shtyrë për tri vjet, janë rritur edhe shpenzimet e ndërtimit për 16% në krahasim me planin, pa llogaritur këtu edhe koston e objektit të rrënuar që nuk kishte shumë kohë që ishte ndërtuar enkas për këtë klinikë. Kemi dhënë gjashtë rekomandime.

## 8. Efikasiteti në planifikimin dhe menaxhimin e projektit “Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës”

- **Entiteti nën auditim:** Komuna e Malishevës
- **Mesazhi i auditimit:** Projekti i ndërtimit të sheshit, nënkalimeve dhe parkingut nëntokësor në Malishevë përbën investimin më të madh komunal, me vlerë të kontraktuar prej 8.28 milionë €. Auditimi ka treguar se Komuna nuk ka qenë efikase në planifikim dhe menaxhim, çka është reflektuar në punë shtesë, ndryshime të konsiderueshme dhe tejkalim të vlerave të planifikuara.

Projekti ka filluar në janar 2023 me vetëm 2 milionë € të buxhetuara, ndërsa përveç kontratës bazë është lidhur edhe një aneks-kontratë mbi 800 mijë €, si dhe priten rreth 500 mijë € kosto shtesë deri në përfundim; po ashtu, rreth 520 mijë € janë ridestinuara nga projekte të tjera për realizimin e tij. Janë evidentuar dallime të theksuara ndërmjet sasive të kontraktuara dhe atyre të realizuara në 302 nga 802 pozicione (37%), ndërkohë që projekti nuk ka qenë i bazuar në një Plan Zhvillimor Urban, nuk janë zhvilluar konsultime me qytetarët dhe palët e interesit, dhe lejet ndërtimore janë siguruar vetëm pas fillimit të punimeve. Zhvillimet gjatë realizimit të projektit kanë krijuar vështirësi për qytetarët dhe bizneset, ndërsa masat lehtësuese nga Komuna kanë qenë të pamjaftueshme, prandaj janë dhënë nëntë rekomandime për Komunën e Malishevës.

## 9. Efikasiteti në realizimin e projektit “Rehabilitimi i Linjës 10 Hekurudhore Hani i Elezit – Leshak”

- **Entitetet nën auditim:** Infracos-i, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Ekonomisë, (përfshirë Njësine për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike).
- **Mesazhi i auditimit:** Projekti kishte për qëllim modernizimin e Linjës 10, por pavarësisht afatit fillestar për përfundim në vitin 2019, ai kishte mbetur i papërfunduar edhe në fund të vitit 2024. Deri tani janë realizuar rreth 60% të Fazës I dhe 32% të Fazës II, ndërsa për Fazën III nuk ka projekt të hartuar. Nga 250 milionë euro të planifikuara, janë paguar 92.3 milionë euro.

Auditimi ka identifikuar rritje të konsiderueshme të kostove (rreth 30 milionë euro shtesë), kryesisht si rezultat i ndryshimeve të kontratave bazë. Po ashtu janë evidentuar mangësi në menaxhim, koordinim ndërinstitucional, vendimmarrje dhe mbikëqyrje të kontratave. Mbyllja e linjave Fushë Kosovë–Hani i Elezit dhe Fushë Kosovë–Mitrovicë është vlerësuar si proces jotransparent dhe me mbikëqyrje të pamjaftueshme nga institucionet përgjegjëse. Janë dhënë 11 rekomandime: dy për MMPHI-në, dy për ME-në dhe shtatë për Infracosin.

## 10. Menaxhim i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

- **Entitetet nën auditim:** Ministria e Ekonomisë, Operatori i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu SH.A. dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë.
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria e Ekonomisë, nuk kishte arritur caqet e vendosura për burime të ripërtërishme të energjisë në kapacitet prej 800 MW për vitin 2020. Totali i kapacitetit të instaluar në kuadër të skemave mbështetëse deri në vitin 2024 ishte 310 MW, që përfaqëson më pak se 40% të caqeve të përcaktuara. Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka ushtruar monitorim efektiv mbi mënyrën se si KOSTT-i ka menaxhuar Fondin. Për më tepër, ZRRE-ja ka ulur përgjegjësinë financiare të prodhuesve për jo-balancat nga 25% në vetëm 5%, gjë që ka rritur koston për KOSTT-in.

KOSTT-i nuk kishte arritur të menaxhojë në mënyrë efektive fondin pasi nuk ka ndërmarrë masa që të minimizojë nivelin e jo-balancave ndërmjet energjisë së parashikuar dhe asaj realisht të prodhuar. Për pasojë, sa më i lartë të jetë niveli i jo-balancave, aq më shumë rriten shpenzimet e KOSTT-it për blerjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë. Edhe pse tepricën e energjisë së BRE-së, KOSTT-i e kishte kaluar në llogarinë balancuese, megjithatë të hyrat që dalin nga kjo llogari janë dukshëm më të ulëta se të hyrat që do të realizoheshin nëse jo-balancat janë më të ulëta. Janë dhënë nëntë rekomandime.

## 11. Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit “Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK-në dhe GPK-në për vitin 2021”

- **Entitetet nën auditim:** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe komunat Gjakovë, Klinë dhe Viti.
- **Mesazhi i auditimit:** Ministria, megjithëse ka ndërmarrë disa hapa për zbatimin e rekomandimeve, nuk ka arritur të sigurojë progres të mjaftueshëm dhe zbatim të plotë të tyre. Vonesat në fillimin e procesit të raportimit të Performancës Komunale për vitin 2024, tejkalimi i kompetencave nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës Komunale në ndryshimin e të dhënave të raportuara nga komunat, si dhe mungesa e udhëzimeve të qarta lidhur me përdorimin e të dhënave të regjistrimit të popullsisë, kanë krijuar pasiguri, jokonsistencë në raportim dhe kanë cenuar besueshmërinë, krahasueshmërinë dhe integritetin e procesit të vlerësimit të performancës komunale.

## 12. Integrimi i sistemeve, krijimi i deponisë së të dhënave dhe implementimi i inteligjencës së biznesit

- **Entiteti nën auditim:** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- **Mesazhi i auditimit:** Rezultatet e auditimit tregojnë se, përkundër avancimit të sistemit Deponia e të Dhënave dhe shfrytëzimit të tij nga një numër i departamenteve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ende nuk ka arritur ta shtrijë përdorimin e tij të të gjithë zyrtarët përdorues. Zyrtarët e modelimit makroekonomik vazhdojnë të përdorin raporte të dyfishta dhe të marrin të dhëna nga Dogana e Kosovës dhe ATK-ja përmes e-mail-it ose platformave online si Open Data. Në MFPT nuk ka strategji të miratuar për TI-në, nuk ka dokumentim të ndërlidhjeve të reja të të dhënave në sistem, nuk ka funksionalitet të plotë të ditarit të aktiviteteve për raportim në kohë reale, si dhe mungon një proces i automatizuar për verifikimin e suksesshëm të transferimit të të dhënave. Lidhur me këto mangësi, janë dhënë gjashtë rekomandime.

## 13. Platforma e shërbimeve online e-Kosova

- **Entitetet nën auditim:** Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit.
- **Mesazhi i auditimit:** Platforma e-Kosova ka bërë përparime në digjitalizimin e shërbimeve publike, duke mundësuar ofrimin elektronik të rreth 230 shërbimeve dhe duke përmirësuar qasjen, transparencën dhe efikasitetin në administratën publike. Megjithatë, platforma ka mangësi në menaxhimin e kontratave dhe në zhvillimin e sistemeve, pasi në marrëveshjet për zhvillim dhe mirëmbajtje mungojnë klauzola të qarta për mbrojtjen e të dhënave dhe reagimin ndaj incidenteve të sigurisë. Kontrolllet e sigurisë së informacionit nuk garantojnë mjaftueshëm integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e sistemit, ndërsa mungojnë mekanizma të mjaftueshëm për vazhdimësinë e biznesit dhe rikuperimin nga fatkeqësitë. Po ashtu, kontrolllet e aplikacionit në shërbimet e audituara nuk sigurojnë që të përpunohen vetëm të dhëna të sakta dhe të vlefshme, duke lejuar aplikime të dyfishta dhe pagesa të përsëritura. Lidhur me këto mangësi, janë dhënë 15 rekomandime.

## 14. Sistemi i Tatimit në Pronë – SITP

- **Entitetet nën auditim:** Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Pronës.
- **Mesazhi i auditimit:** Sistemi i Tatimit në Pronë - SITP luan një rol kyç në administrimin e tatimit në pronë dhe ofron një platformë të integruar të të dhënave të tatimit në pronë që përdoret në nivelin lokal të Republikës së Kosovës. Zhvillimi i këtij sistemi ka transformuar administrimin e tatimit në pronë duke e bërë më të menaxhueshëm si platformë të centralizuar me një bazë të të dhënave të vetme për të gjitha komunat. Megjithatë Sistemi i Tatimit në Pronë nuk garanton plotësisht ofrimin e të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Dobësitë në zhvillim dhe funksionim të sistemit, mungesa e procedurave të standardizuara për testim dhe aprovime, si dhe kontrolllet e pamjaftueshme, kanë ndikuar negativisht në integritetin e të dhënave dhe menaxhimin efikas të tatimit. Po ashtu mangësitë në kontrolllet e sigurisë së sistemit të tatimit në pronë e bëjnë sigurinë e informacionit më të cenueshme ndaj keqpërdorimeve. Kjo ka rritur rrezikun për pasaktësi në llogaritje, shpërndarje të gabuar të pagesave dhe vështirësi në identifikimin e saktë të tatimpaguesve. Në këtë auditim, kemi dhënë gjithsej 14 rekomandime.

Krahas auditimeve, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve, thellimit të bashkëpunimit dhe ngritjes profesionale gjatë vitit 2025 Zyra Kombëtare e Auditimit ka zhvilluar një sërë aktiviteteve në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

### 3.6. Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Auditim

Zyra Kombëtare e Auditimit e realizon menaxhimin e cilësisë në procesin e auditimit në përputhje me vizionin, misionin dhe mandatin e institucionit, me qëllim ofrimin e auditimeve cilësore dhe rritjen e besueshmërisë së raporteve të auditimit. Në këtë kuadër, ZKA-ja po e zhvillon dhe konsolidon Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, në përputhje me kërkesat e SNISA 140 (i rishikuar).

Edhe pse ZKA-ja ende nuk ka filluar zbatimin e plotë të kërkesave të SNISA 140 të rishikuar, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa konkretë për operacionalizimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në Auditim. Në këtë drejtim, janë hartuar draft-udhëzuesit për tri procese kyçe:

- Udhëzuesi mbi Zbatimin e Procesit për Menaxhimin e Rreziqeve të Cilësisë;
- Udhëzuesi mbi Monitorimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë;
- Udhëzuesi mbi Vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë.

Po ashtu, në proces është hartimi i Politikës së Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në Auditim, e cila synon të përcaktojë parimet, përgjegjësitë dhe mënyrën e funksionimit të sistemit, si dhe të sigurojë bazë të qartë institucionale për zbatimin progresiv të kërkesave të SNISA 140.

Qëllimi kryesor i auditimit është të ofrojë siguri për palët e interesit dhe publikun e gjerë lidhur me cilësinë e raporteve të auditimit, menaxhimin financiar dhe rregullsinë e përdorimit të fondeve publike, duke e arritur këtë përmes një qasjeje të integruar të cilësisë gjatë ciklit të auditimit.

Rëndësia e realizimit të auditimeve në përputhje me standardet profesionale dhe parimet e INTOSAI-t përfshin disa aspekte kryesore, si:

- Sigurimin e cilësisë në auditimet e realizuara;
- Forcimin e besueshmërisë së palëve të interesit në raportet e auditimit;
- Rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së procesit të auditimit.

ZKA-ja ofron auditime në pajtueshmëri me udhëzuesit e auditimit, rregulloret dhe aktet e tjera që rregullojnë aktivitetet e institucionit. Këto akte përcaktojnë metodologjinë e realizimit të auditimeve dhe ofrojnë udhëzime të nevojshme për auditorin gjatë procesit të auditimit, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, parimet e INTOSAI-t dhe udhëzimet e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (KDPI).

### 3.7. Rishikimi i Cilësisë së Angazhimeve

Në kuadër të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, ZKA-ja siguron cilësinë e auditimeve përmes Rishikimit të Cilësisë së Angazhimeve. Ky rishikim zbatohet gjatë gjithë ciklit të auditimit dhe realizohet në disa nivele, duke përfshirë:

- **Udhëheqësin e ekipit të auditimit**, i cili ka përgjegjësi të vazhdueshme për menaxhimin e auditimit, udhëheq vlerësimin e rrezikut dhe përgatit Memorandumin planifikues dhe procedurat e auditimit. Përveç kësaj, siguron cilësinë e punës përmes mbikëqyrjes së ekipit, diskutimeve të rregullta dhe dokumentimit të gjykimeve/vendimeve, merr vendime për metodat e auditimit, mban kontakte të përditshme me entitetin e audituar dhe përgatit draft-raportin e auditimit;
- **Drejtorin e departamentit të auditimeve**, i cili është “rojtari i cilësisë dhe konsistencës” dhe është përgjegjës të sigurojë që ekipi punon në pajtim me standardet e auditimit dhe etikën profesionale të ZKA-së, duke formuluar strategjinë e auditimit, përcaktuar procedurat për vlerësimin e rrezikut, dakorduar rreziqet domethënëse dhe miratuar planin/programet e auditimit para fillimit të punës. Përveç kësaj, ai/ajo rishikon vendimet dhe gjykimet e rëndësishme profesionale, rishikon dhe merr vendime lidhur me raportet e auditimit dhe opinionet që duhen dhënë, duke siguruar cilësinë dhe konsistencën e angazhimit në pajtim me metodologjinë dhe standardet profesionale.
- **Departamentin për Sigurimin e Cilësisë në Auditim**, i cili kryen rishikime të pavarura dhe të strukturuar të planifikimeve dhe angazhimeve të realizuara, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik dhe kriteret e përzgjedhjes, me qëllim identifikimin e fushave për përmirësim dhe forcimin e konsistencës së praktikave audituese.

Rishikimi i Cilësisë së Angazhimeve synon të sigurojë që procesi i auditimit dhe raportimi përfundimtar të jenë në pajtueshmëri me standardet, udhëzuesit e auditimit dhe kërkesat e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, si dhe të kontribuojë në rritjen e besueshmërisë së raporteve dhe transparencës së procesit të auditimit. Departamenti për Sigurimin e Cilësisë në Auditim është përgjegjës për rishikimin e planifikimeve dhe auditimeve të realizuara. Gjatë vitit 2025, auditimet për rishikim janë përzgjedhur duke u bazuar në madhësinë dhe kompleksitetin e tyre, si dhe në mbulueshmërinë e ekipeve gjatë rishikimit të dosjeve të auditimit.

Për sezonin auditues 2024/25, Departamenti për Sigurimin e Cilësisë ka realizuar 22 rishikime të dosjeve të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë për fazën e ekzekutimit dhe raportimit, Për sezonin auditues 2025/26, Departamenti ka realizuar 22 rishikime për fazën e planifikimit të auditimeve.

Në auditimet e performancës, rishikimi i cilësisë është pjesë e domosdoshme e çdo angazhimi. Planifikimi, ekzekutimi dhe raportimi i nënshtrohen rishikimit nga nivelet menaxheriale, ndërsa memorandumit i parastudimit dhe draft-raportit rishikohen kolegjalisht nga auditorë me përvojë brenda departamentit. Për tema të caktuara, ZKA-ja angazhon edhe këshilltarë të jashtëm nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, me qëllim sigurimin e një proces - auditimi me cilësi të lartë.

# 04

**Menaxhimi Financiar  
dhe Administrativ**

## Kapitulli IV - Menaxhimi Financiar dhe Administrativ

### 4.1. Menaxhimi financiar

Zyra Kombëtare e Auditimit financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe si i tillë menaxhohet dhe shpenzohet me një përgjegjësi dhe llogaridhënie të lartë. Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, mjetet e ndara për ZKA-në ishin në shumë prej 3,532,633. €.

Buxheti ishte i ndarë në katër kategori ekonomike, si në vijim:

- Pagat dhe Shtesat në vlerë prej **2,566,933€;**
- Mallrat dhe Shërbimet në vlerë prej **825,700€;**
- Shërbimet Komunale në vlerë prej **40,000€** dhe
- Investimet Kapitale në vlerë prej **100,000€.**

Buxheti final në fund të vitit ishte **3,396,315€.**

Në kategorinë “Pagat dhe Shtesat” sipas Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, në muajin korrik është alokuar shuma prej 60,715.46 € për rritjen e vlerës së koeficientit.

Me vendim të Qeverisë të Republikës së Kosovës Nr. 01/281 të datës 24.12.2025, bazuar në Nenin 15, paragrafi 5 i Ligjit Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, Zyrës Kombëtare të Auditimit në kategorinë “Pagat dhe Shtesat” në emër të kursimeve i është zvogëluar shuma buxhetore në vlerë prej 207,931.19 € nga ndarja fillestare.

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 04/282 të datës 26.12.2025, bazuar në Nenin 15, paragrafi 5 i Ligjit Nr.08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025, Zyrës Kombëtare të Auditimit në kategorinë “Mallrat dhe Shërbimet” në emër të kursimeve i është zvogëluar shuma buxhetore në vlerë prej 48,602.86 € nga ndarja fillestare.


Gjatë vitit 2025, Zyra Kombëtare Auditimit ka realizuar të hyra në vlerë të përgjithshme prej 22,600.00 €, në emër të shitjes së shërbimeve të auditimit. Shërbimet e kryera audituese janë për projektin “Përcjellja e rekomandimeve për raportin e auditimit mbi Mekanizmat e sigurimit të cilësisë së të dhënave të raportuara për SMPK-në dhe GPK-në për vitin 2021”, e Helvet-as Swiss Intercooperation Kosovo (HSIK-DEMOS).

Buxheti total i shpenzuar gjatë vitit 2025 në të gjitha kategoritë ekonomike është në vlerë 3,260.905.48 €, shprehur në përqindje 96.01 % të buxhetit final.


Tabela 6. Shpenzimi i buxhetit përgjatë tri viteve 2025-2023 (në EUR `000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
2025				
Buxheti i përgjithshëm	3,533	3,396	3,261	96.01
Pagat dhe Shtesat	2,567	2,420	2,420	100 %
Mallrat dhe Shërbimet	826	811	708	87.27 %
Shërbimet Komunale	40	40	35	86.80%
Investimet Kapitale	100	125	98	78.56 %
2024				
Buxheti i përgjithshëm	3,346	3,093	2,926	95%
Pagat dhe Shtesat	2,388	2,168	2,168	100%
Mallrat dhe Shërbimet	768	729	603	83%
Shërbimet Komunale	40	40	33	83%
Investimet Kapitale	150	156	122	78%
2023				
Buxheti i përgjithshëm	3,267	3,052	2,877	94%
Pagat dhe Shtesat	2,414	2,173	2,171	100%
Mallrat dhe Shërbimet	738	765	633	83%
Shërbimet Komunale	40	40	36	89%
Investimet Kapitale	74	74	37	50%

Grafiku 1. Shpenzimet krahasuar me buxhetin final sipas kategorive ekonomike në vitet 2025-2023



Grafiku 2. Pjesa e shpenzimit sipas kategorive ekonomike në përqindje për vitin 2025



Pjesa më e madhe e buxhetit final të Zyrës Kombëtare të Auditimit është shpenzuar në kategorinë “Pagat dhe Shtesat”, në vlerë prej (2,419,717€) e cila përbën 74.21 % të shpenzimeve totale.

Ndërsa shpenzimet në kategoritë e tjera janë realizur si vijon :

- Mallrat dhe Shërbimet me **21.71%**,
- Shpenzimet Komunale me **1.07 %** dhe
- Investimet Kapitale me **3.01 %**

Krahas buxhetit final në kategori ekonomike në përqindje kategoria e Pagave dhe Shtesave është shpenzuar 100%, Mallrat dhe Shërbimet 87.27 %, Shërbimet Komunale 86.80 % dhe Investimet Kapitale 78.56 %.

- Në kategorinë “Pagat dhe Shtesat” është miratuar ndarja buxhetore në vlerë 2,566,933€, ndërsa numri i miratuar i personelit ishte 185. Buxheti i shpenzuar në paga dhe shtesa është 2,419,717€, shprehur në përqindje 100% e buxhetit final.

Sipas vendimit të qeverisë për kursime ZKA-së i është zvogëluar buxheti në vlerë prej 207,931€, shprehur në përqindje 8.10 % e buxhetit fillestar sipas ligjit.

Përqindja më e ulët e shpenzimeve në këtë kategori ekonomike gjatë vitit 2025 krahasuar me buxhetin e aprovuar ka ardhur për arsyt si në vijim:

- Njëmbëdhjetë nëpunës kanë dhënë dorëheqje nga ZKA-ja.
- Dy nëpunës janë pensionuar.
- Tre nëpunës kanë qenë në pushim pa pagesë.
- Katër nëpunës kanë shkuar në pushim të lehonisë dhe
- Gjashtë nëpunës janë në proces të rekrutimit.


Në kategorinë “Mallrat dhe Shërbimet” është miratuar ndarja fillestare e buxhetit prej 825,700€, nga fondi burimor 10 (BKK), gjithashtu është përfshirë donacioni i pranuar në dhjetor të vitit 2025 në vlerë prej 13,000.00€, si dhe ai i bartur nga viti 2024 në vlerë prej 21,325.94€. Totali i donacionit në mallra dhe shërbime është në vlerë prej 34,325.94€. Si rezultat, buxheti total nga fondi burimor 10 (BKK) së bashku me donacionin arrin vlerën prej 860,025.94€. Pas zbatimit të kursimeve nga vendimi i qeverisë në vlerë prej 48,602.86 € buxheti final për këtë kategori është 811,423.€, shprehur në përqindje 5.65 % më pak krahasuar me buxhetin fillestar për vitin 2025.

Në muajin dhjetor të vitit 2025 kemi pranuar donacionin nga ISA-ja e Arabisë Saudite për mbështetje financiare me qëllim të përmirësimit të performancës së TI-së në vlerë prej 34,000€, nga kjo shumë 13,000€ janë kategorizuar në Mallra dhe shërbime ndërsa 21,000€ si shpenzime kapitale.

Mjetet e pashpenzuara nga donacioni i ISA-së së Arabisë Saudite në kategorinë “Mallra dhe Shërbime” janë në vlerë prej 13,710.94€, të cilat do të barten në vitin 2026.

Shpenzimet në këtë kategori në fund të vitit 2025 ishin 687,520€ nga fondi 10 (BKK) dhe 20,615€ nga donacioni, në një total prej 708,135€ shprehur në përqindje 87.27 % të buxhetit final.

Grafiku 3 – Shpenzimet analitike në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2025



Shpenzimet më të larta (emërtim) për zëra të shprehur në % në kategorinë “Mallrat dhe Shërbimet” janë:

- Qiraja për objektin ku ndodhet selia e ZKA-së dhe hapësirat e tjera – në vlerë prej 217,000.00€, shprehur në përqindje 31%. Ky zë vazhdon të paraqesë njërin nga shpenzimet më të mëdha në kategorinë Mallrat dhe Shërbimet.
- Mirëmbajtja – në vlerë prej 52,540.00€, shprehur në përqindje 7.42%, Këtu përfshihen - mirëmbajtja higjienike dhe sigurimi fizik i objektit të ZKA-së.
- Shërbimet këshillëdhënëse profesionale - në vlerë prej 29,750.00€, shprehur në përqindje 4.20%. Këtu përfshihen shpenzimet për auditimin e komunave dhe institucioneve të pavarura.
- Shërbimet e arsimit dhe trajnimit - në vlerën prej 27,811€, shprehur në përqindje 3.93 %.
- Pajisjet tjera të teknologjisë informative dhe të komunikimit - ku përfshihen shpenzimet për blerjen e kompjuterëve në vlerë prej 41,003€ në të cilat përfshihen 35 laptopë të blerë prej donacionit në vlerë prej 20,615€, shprehur në përqindje 5.79 %;
- Nga shpenzimet tjera përfshihen shpenzimet që ndërlidhen me licencat dhe mirëmbajtja e tyre, furnizim me ujë të pijshëm, softueret, telefonia mobile si dhe shpenzime tjera në vlerë prej 201,529.14 € shprehur në përqindje 28.46 %.
- Naftë për nxemje qendrore për objektin e ZKA-së bashkë me shpenzimet e naftës për veturat zyrtare dhe vaj në vlerë prej 40,184.00€, shprehur në përqindje 5.67%;
- Udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, ku përfshihen shpenzimet për mëditje dhe akomodim të menaxhmentit dhe personelit të ZKA-së gjatë udhëtimeve zyrtare brenda dhe jashtë vendit. Në total shpenzimet në këto zëra arrijnë vlerën prej 98,318.00€, shprehur në përqindje 13.88%.

Prej tyre 76,292.00€ (ose 10.77 %) prezantojnë shpenzimet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Këto shpenzime lidhen me pjesëmarrjen e personelit në përfaqësime të ndryshme profesionale, si: trajnime, vizita studimore, konferenca me qëllim të ngritjes profesionale, angazhime në ndarjen e përvojave për auditime të shpejta, në kohë reale, investigative etj. Po ashtu këto shpenzime përfshijnë, pjesëmarrjen në auditimin e ambasadave të Republikës së Kosovës, pjesëmarrjes në auditimet paralele me ISA-të partnere jashtë Kosovës si dhe pjesëmarrjen në takimet me partnerët tanë ndërkombëtarë me financim nga donatorët.

Në kategorinë “Shërbimet Komunale” është miratuar ndarja buxhetore në vlerë prej 40,000€. Buxheti është shpenzuar në vlerën prej 34,718€, shprehur në përqindje 86.80%. Përqindja më e lartë në këtë kategori është shpenzimi i rrymës në vlerë (29,070.33 €) që përfshin 83.73 % e të gjitha shpenzimeve.

Në kategorinë “Investime Kapitale” është miratuar ndarja buxhetore në vlerë 100,000.00€ nga fondi burimor 10 (BKK), gjithashtu është përfshirë donacioni i pranuar në dhjetor të vitit 2025 në vlerë prej 21,000€, si dhe i bartur nga viti 2024 në vlerë prej 4,175€. Totali i donacionit në investime kapitale është në vlerë prej 25,175.06 €. Si rezultat, buxheti total nga fondi burimor 10 (BKK) së bashku me donacionin arrin vlerën prej 125,175€. Shpenzimet në këtë kategori në fund të vitit 2025 ishin 94,160€ nga fondi 10 (BKK) dhe 4,175€ nga donacioni, në një total prej 98,335€, shprehur në përqindje 78.56 % të buxhetit final.

Në shumën e përgjithshme është e përfshirë blerja e 3 (tri) veturave të reja zyrtare për nevoja të personelit të ZKA-së në vlerë prej 94,160.00€ (nga buxheti i ZKA-së), blerja e një kompjuteri në vlerë prej 1,698€ (nga donacioni i ISA-së së Arabisë Saudite) si dhe një altoparlant mobil në vlerë prej 2,477€ (nga donacioni i ISA-së së Arabisë Saudite).



05

**Burimet Njerëzore**

## Kapitulli V- Burimet Njerëzore

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-055, ZKA-ja ka të aprovuar kornizën e brendshme rregullative përmes së cilës rregullon menaxhimin dhe funksionimin e burimeve njerëzore. Departamenti për menaxhimin e burimeve njerëzore ofron përkrahje profesionale për të gjithë personelin e ZKA-së, rrjedhimisht ushtrimi i veprimtarisë është në përputhje të plotë me rregullativën ligjore në fuqi dhe me udhëzuesit dhe politikat e INTOSA-t dhe EUROSAI-t.

### 5.1. Burimet Njerëzore dhe zhvillimi profesional

ZKA-ja ofron mjedis bashkëpunues institucional, të vlerësuar, me personel të përgatitur profesionalisht, të përkushtuar dhe motivuar me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, arritjen e rezultateve dhe demonstrimin e vlerave institucionale.

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është një strukturë funksionale që siguron menaxhimin efektiv të të gjitha proceseve, ku përfshihet:

- Rekrutimi i personelit;
- Trajnimi dhe Zhvillimi;
- Menaxhimi i Sistemit të Performancës;
- Promovimi;
- Pagat, shtesat dhe kompenzimet tjera;
- Këshillat Profesionale për personelin etj.

Departamenti i Burimeve Njerëzore kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit institucional dhe në ndërtimin e një kulture organizative të bazuar në profesionalizëm, integritet dhe bashkëpunim.

**Struktura e personelit klasifikohet sipas: përgjegjësisë; kompleksitetit; kualifikimeve; përvojës profesionale dhe përvojës menaxheriale.**

Personeli në ZKA ndahet në pesë kategori, si në vijim:

- Kategori e lartë drejtuese;
- Kategori e mesme drejtuese;
- Kategori e ulët drejtuese;
- Kategori profesionale;
- Kategori mbështetëse.

ZKA-ja e ka të rregulluar procesin e rekrutimit dhe statusin e të punësuarve në përputhje me parimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, duke garantuar transparencë, profesionalizëm dhe respektim të standardeve ligjore.

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja ka rekrutuar 21 punonjës të rinj, si dhe një personel është angazhuar në Kabinetin e Auditorës së Përgjithshme ndërsa marrëdhënien e punës e kanë shkëputur 14 punonjës, ku përfshihen 11 dorëheqje dhe dy punonjës kanë arritur moshën e pensionimit. ZKA-ja në fund të vitit 2025 kishte 171 punonjës.

Struktura e përgjithshme e personelit përbëhet prej **78% personel auditues** dhe **22% personel të përkrahjes profesionale mbështetëse**.

Tabela në vijim paraqet të dhënat e personelit, ku përfshihet numri i përgjithshëm i punonjësve, përqindja e gjinisë femërore dhe mashkullore, moshë mesatare e përgjithshme në ZKA, numri i punonjësve nga komunitetet si dhe përqindja e lëvizjeve/largimeve të punonjësve.

Tabela 7 - Personeli i ZKA-së, përgjatë tre viteve të fundit:

Viti	Numri i personelit në fund të vitit	Personeli Gjinia Femërore (%)	Personeli Gjinia mashkullore (%)	Moshë Mesatare (vite)	Numri i personelit nga komunitetet	Lëvizja e personelit %
2025	171	57.9%	41.5%	46	3	7%
2024	162	56%	44%	43.98	3	6.8%
2023	163	56.44%	43.56%	43.33	3	6.55%

Moshë mesatare e nëpunësve të ZKA-së është 46 vjet, prej tyre të moshës prej 24 deri në 50 vjet janë 78.4 % kurse 21.6% janë të moshës prej 51 deri në 64 vjet.

Kategoria e Lartë Drejtuese përbëhet nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm; Ndihmës Auditorët e Përgjithshëm dhe Drejtori i Përgjithshëm. Numri i përgjithshëm në këtë kategori është shtatë prej tyre dy nga gjinia femërore dhe pesë nga gjinia mashkullore.

ZKA-ja ndër vite i ka kushtuar rëndësi të veçantë krijimit dhe ruajtjes së një balanci gjinor, duke promovuar barazinë dhe mundësitë e barabarta për të gjithë personelin. Në këtë drejtim i është dhënë theks i posaçëm rritjes së numrit të pozitave udhëheqëse nga gjinia femërore, si pjesë e angazhimit tonë për fuqizimin e tyre në role vendimmarrëse dhe drejtuese. Ky angazhim ka kontribuar në ndërtimin e një kulture organizative më të barabartë, më përfaqësuese dhe më efektive në përmbushjen e objektivave institucionale.

Tabela 8- Struktura udhëheqëse në të gjitha funksionet

Viti	Pozita udhëheqëse (Gjinia Femërore)	Përqindja %	Pozita udhëheqëse (Gjinia Mashkullore)	Përqindja %
2025	37	58.7%	26	41.3%
2024	37	58%	27	42%
2023	37	54.41%	31	45.59%

Tabela e mësipërme paraqet strukturën udhëheqëse të ZKA-së në tri (3) vitet e fundit. Në këtë strukturë përfshihen: Drejtorët e Departamentit të Auditimit, Drejtori i Auditimit të Brendshëm; Drejtorët e Departamenteve Mbështetëse Funktionale në Auditim dhe Përkrahja Administrative; Udhëheqësit e Divizioneve dhe funksioni Udhëheqës i Ekipit.

**Personeli Auditues** përbën pjesën më të madhe të personelit në institucion.

Kategoria profesionale audituese përbëhet nga pozitat si në vijim:

- Auditor Specialist;
- Ekspert i Auditorit në fushën e ndërtimtarisë;
- Auditor Senior (auditime financiare dhe pajtueshmëri; auditime të performancës dhe auditime të Teknologjisë së Informacionit).
- Auditor (auditime financiare dhe pajtueshmëri; auditime të performancës dhe auditime të Teknologjisë së Informacionit).
- Auditor junior (auditime financiare dhe pajtueshmëri dhe auditime të performancës).

Tabela 9 - Pozitat në kategoritë audituese profesionale sipas viteve 2023-2025

Viti	Financiar & Pajtueshmëri			Performancë Prokurim & TI			Auditor Specialist
	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	Auditor Senior	Auditor	Auditor Junior	
2025	50	17	16	10	7	4	3
2024	48	15	18	9	6	3	6
2023	51	15	19	10	3	6	7

Zhvillimi i karrierës në kuadër të ZKA-së është i rregulluar me procedurë ligjore dhe përfshin lëvizjen brenda kategorisë, lëvizjen e auditorëve brenda kategorisë funksionale si dhe ngritjen në detyrë.

Në vitin 2025 në Zyrën Kombëtare të Auditimit janë promovuar 10 punonjës në nivelet profesionale: Auditor dhe Auditor Senior.


## 5.2. Zhvillimi profesional

Zyra Kombëtare e Auditimit investon në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin e kapaciteteve institucionale, përmes përkrahjes së zhvillimit profesional të personelit, krijimit të kushteve për angazhim maksimal dhe promovimit të një kulture bashkëpunimi dhe përgjegjësie. Këto përpjekje kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e obligimeve ligjore dhe në arritjen e rezultateve përmes auditimeve të besueshme, efikase dhe efektive.

Personeli auditues është anëtar i shoqatave profesionale të licencuara për kontabilitet dhe auditim, ku në baza vjetore ndjek modulet obligative për Edukim të Vazhdueshëm Profesional, në përputhje me standardet dhe kërkesat profesionale. Kjo siguron përditësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe përputhshmërinë me zhvillimet më të fundit në fushën e auditimit dhe kontabilitetit.

Përveç trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional, personeli auditues ka fituar edhe thirrjet e nevojshme certifikuese sipas niveleve përkatëse profesionale, duke dëshmuar kompetencë, integritet dhe përkushtim në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Grafiku 5 - Shpërndarja e personelit auditues sipas niveleve të certifikimit




Numri i përgjithshëm i personelit të certifikuar (në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë) në skemën e certifikimit publik është 97, prej tyre 81 auditorë të certifikuar në sektorin publik, 14 auditorë të sektorit publik dhe dy asistentë të auditorit në sektorin publik.

Personeli auditues i angazhuar në auditimet e performancës është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme nga programet për Zhvillimin e Kapaciteteve Institucionale, duke rezultuar me certifikimin e suksesshëm të 12 auditorëve të performancës. Në fushën e Auditimeve të Teknologjisë së Informacionit, aktualisht janë dy auditorë të certifikuar, ndërsa një auditor është në proces të certifikimit.

Njohuritë profesionale të personelit plotësohen dhe avancohen përmes ndjekjes së trajnimeve të vazhdueshme, të orientuara sipas nevojave konkrete të punës. Identifikimi i këtyre nevojave realizohet gjatë procesit të vlerësimit vjetor të performancës, duke siguruar që zhvillimi profesional të jetë i lidhur ngushtë me objektivat individuale dhe institucionale.

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Metodologji, koordinon aktivitetet përkatëse dhe kontribuon në hartimin dhe zbatimin e Planeve Vjetore të Trajnimit. Ky bashkëpunim garanton që përmbajtja e trajnimeve të jetë në përputhje me standardet profesionale, kërkesat ligjore dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e auditimit.

Plani i Trajnimeve për vitin 2025 përfshin një shtrirje të gjerë të aktiviteteve trajnuese përgjatë gjithë vitit kalendarik, duke mbuluar fusha të ndryshme profesionale. Nga këto trajnime ka përfituar i gjithë personeli, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale, përmirësimin e performancës dhe forcimin e cilësisë së auditimeve të realizuara nga institucioni.



Personeli i ZKA-së ka marrë pjesë në 41 aktivitete të zhvillimit profesional të organizuara nga personeli i brendshëm i ZKA-së dhe shoqatat profesionale. Përveç tyre, janë zhvilluar punëtori dhe vizita studimore jashtë vendit, ndër të cilat veçojmë temat:

- Vlerësimi i rreziqeve dhe testimi i kontrolleve të brendshme
- Letërkonfirmimet e jashtme SNISA 505
- Opinionet e Auditimit në auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë
- Trajnim për trajner (Gjuha e thjeshtë)
- Vlerësimi i Auditimit të Brendshëm SNISA 610
- Trajnim në Exel të avancuar
- Trajtime të avancuara në softuerin SITA - Faza e ekzekutimit/raportim
- Mostrimi në auditim shembull praktik me IDEA
- Korniza Ligjore për ZKA
- Zotërimi i aftësive të vizualizimit dhe raportimi efektiv për auditorët (Kërkesë për bashkëpunim me – CEF-në)
- Analitika e të dhënave në Trajnimin e Auditimit Financiar
- Mbrojtja e të Dhënave Personale
- Procesi i Auditimit në SITA
- Procesi i Auditimit Financiar dhe Pajtueshmërisë
- Procesi i Auditimit të Performancës
- Punëtorja nga KPMG dhe ZKA-ja (Punëtorja për ndërtimin e kapaciteteve)
- Trajnimi për gjuhë të thjeshtë
- Kontrolli i brendshëm: Verifikimi, Auditimi për Fondet e BE-së
- Kuptimi dhe zbatimi i Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm
- Gjetjet nga Rishikimi i Cilësisë së Angazhimit
- Zbatimi i drejtë dhe efektiv i mekanizmit të sinjalizimit
- Kodi i Etikës
- Konflikti i Interesit

### 5.3. Auditorët e ZKA-së përfundojnë me sukses programin “LOTA Pioneers”

Zyra Kombëtare e Auditimit përfundoi me sukses programin dyvjeçar “Pionierët përmes Avancimit të Teknologjisë (LOTA Pioneers)”, të organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t. Ky program synon të zhvillojë agjentë ndryshimi brenda Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA), duke ndihmuar përdorimin e teknologjisë në auditim dhe vlerësimin e aplikimeve të teknologjisë nga qeveritë në shërbimet publike.

Angazhimi i auditorëve të ZKA-së në LOTA Pioneers reflekton përkushtimin e institucionit për avancimin e qasjes teknologjike në auditim dhe ndërtimin e ekipeve profesionale me njohuri të avancuara në këtë fushë. Përvoja e ZKA-së në auditimet e TI-së u prezantua në nivel ndërkombëtar përmes gazetës së EUROSAI-t, me artikullin “KOSOVA: Pikat kryesore të auditimit të TI-së nga ISA e Kosovës”, që trajton gjetjet kryesore dhe analizën e qeverisjes, sigurisë së informacionit dhe kontrolleve të aplikacioneve.

Auditorët e TI-së të ZKA-së po ashtu marrin pjesë në trajnime të avancuara për auditimin e bazave të të dhënave Oracle dhe sigurinë kibernetike, të organizuara në bashkëpunim me institucione rajonale dhe ndërkombëtare. Në shtator 2025 u zhvillua punëtorja për Siguri Kibernetike II në Vlorë, ku morën pjesë auditorë dhe ekspertë nga institucione të auditimit të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Sllovenisë, Turqisë dhe Suedisë.

Një auditore nga ZKA-ja pas përfundimit me sukses të programit “Auditimi i të Ardhmes së Barabartë” (EFA), ka fituar çmimin ndërkombëtar për kontribut të jashtëzakonshëm në avancimin e auditimit me fokus në barazi dhe përfshirje në kuadër të këtij programi. Programi është organizuar nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t dhe ka për qëllim fuqizimin e agjentëve të ndryshimit brenda Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e qasjeve gjithëpërfshirëse dhe të barabarta në auditim.

## 5.4. Shërbimet e përbashkëta

Departamenti për Shërbime të Përbashkëta, përmes divizioneve përkatëse, siguron shërbime të specializuara dhe mbështetje të vazhdueshme për personelin e ZKA-së, duke kontribuar në funksionimin efikas dhe të koordinuar të proceseve të brendshme administrative dhe operative. Ky departament ka rol kyç në garantimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve të përditshme të Institucionit, si dhe në mbështetjen e vazhdueshme të proceseve audituese.

Në kuadër të këtij departamenti funksionojnë këto divizione:

### Divizioni për Logjistikë


Divizioni për Logjistikë ofron mbështetje të vazhdueshme për ekipet audituese, duke siguruar shërbime transporti, mirëmbajtje të mjeteve zyrtare, si dhe furnizim të rregullt me materiale dhe pajisje të nevojshme për punën në zyrë. Njëkohësisht, divizioni kujdeset për administrimin dhe menaxhimin efikas të pasurisë së luajtshme, me qëllim garantimin e kushteve optimale për realizimin e aktiviteteve të auditimit.

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja është furnizuar me tri vetura të reja zyrtare. Aktualisht, ZKA-ja operon me gjithsej 15 vetura zyrtare, prej të cilave tri janë plotësisht të amortizuara. Po ashtu, katër vetura zyrtare, të blera gjatë viteve 2005–2006, janë dorëzuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme për procedura të mëtejshme të tjetërsimit përmes ankandit publik.

Vlera totale e pasurive kapitale në fund të vitit 2025 ishte 409,005€. Në këtë shumë janë përfshirë edhe blerjet e reja gjatë vitit 2025, përfshirë: blerjen e tri veturave të reja zyrtare, blerjen e një autoparlanti mobil, si dhe blerjen e një laptopi.

Vlera totale e pasurive jokatipale në fund të vitit 2025 ishte 56,558€, ku në këtë shumë janë përfshirë edhe blerjet e realizuara gjatë vitit 2025.

Grafiku 6 - Pasuritë kapitale dhe jokatipale ndër vite



Në fund të vitit 2025, me vendim të Auditorës së Përgjithshme është themeluar Komisioni për Inventarizim të Pasurive të ZKA-së, i cili ka përgatitur dhe dorëzuar raportin e inventarizimit. Në raport janë evidentuar konkluzione dhe rekomandime lidhur me gjendjen e pasurive të institucionit, si dhe nevojat për përmirësim të mëtejshme në administrimin e tyre.

### Divizioni për Administrimin e Dokumenteve Zyrtare

Divizioni për Administrimin e Dokumenteve Zyrtare, në bashkëveprim me Departamentin e TI-së, ka vazhduar procesin e menaxhimit dhe arkivimit elektronik të dokumenteve zyrtare, duke siguruar ruajtje të strukturuar, integritet të dokumentacionit dhe qasje të kontrolluar në dokumentet institucionale. Përmes platformës elektronike, auditorëve u mundësohet qasje e shpejtë dhe efektive në dokumentet e arkivuara, të cilat shërbejnë si bazë për zhvillimin e aktiviteteve të auditimit dhe për mbështetjen e proceseve të brendshme.

Gjatë vitit 2025, ky divizion ka protokolluar gjithsej 2,324 dokumente të ndryshme, duke siguruar administrim të rregullt dhe në përputhje me procedurat në fuqi.

### Divizioni për Përkthim dhe Lekturim

Divizioni për Përkthim dhe Lekturim ofron shërbime profesionale të përkthimit të dokumenteve zyrtare në gjuhën angleze dhe serbe, si dhe anasjelltas. Po ashtu, divizioni siguron përkthim simultan dhe konsektiv gjatë takimeve, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera të organizuara nga ZKA-ja, duke garantuar komunikim të qartë dhe efektiv në të gjitha nivelet.

Me qëllim të përmbushjes së vëllimit të shtuar të kërkesave për përkthim dhe respektimit të afateve të përcaktuara, edhe gjatë vitit 2025 është angazhuar një kompani e jashtme për ofrimin e shërbimeve të përkthimit në këto dy gjuhë.

## Prokurimi

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me Planin Vjetor të Prokurimit për vitin 2025, ka zhvilluar gjithsej 44 aktivitete të prokurimit. Këto aktivitete kanë qenë të orientuara kryesisht në sigurimin e furnizimeve dhe realizimin e shërbimeve, në përputhje me nevojat dhe kërkesat e njësive organizative të ZKA-së.

Gjatë vitit 2025, ZKA-ja ka realizuar dhe nënshkruar gjithsej 28 kontrata, sipas natyrës së procedurave të planifikuara të prokurimit, përfshirë: procedurat me vlera të mesme, kuotimin e çmimeve dhe procedurat me vlera minimale. Po ashtu, ZKA-ja ka pasur edhe 4 aktivitete të prokurimit të realizuara përmes Agjencisë së Prokurimit Publik, të cilat janë në proces të ekzekutimit.

Në përputhje me njoftimin zyrtar të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, lidhur me plotësimin/ndryshimin e dokumentit A01 - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOP) nr.001-2022, Njësia e Prokurimit ka filluar përdorimin e dy moduleve të reja të sistemit të prokurimit elektronik: "Moduli për Menaxhimin e Kontratës" dhe "Moduli për Vlerësimin e Performancës së Operatorëve Ekonomikë".

## 5.5. Teknologjia Inforamtive

Gjatë periudhës raportuese, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka realizuar një sërë objektivash strategjike dhe operative, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit institucional, forcimin e sigurisë së informacionit dhe modernizimin e infrastrukturës teknologjike në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Ndër arritjet kryesore të vitit raportues veçohen:

- **Modernizimi i infrastrukturës së TI-së** - Është realizuar azhurnimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së TI-së përmes zëvendësimit të serverëve dhe përditësimit të sistemeve operative, duke rritur stabilitetin, performancën dhe nivelin e sigurisë së sistemeve kritike të institucionit.
- **Stabilizimi i furnizimit me energji në dhomën e serverëve** - Nëpërmjet donacioneve të siguruara, është furnizuar dhe instaluar një inverter, i cili ka kontribuar në stabilizimin e furnizimit me energji elektrike dhe në reduktimin e rrezikut të ndërprerjeve të paplanifikuara të shërbimeve të TI-së.
- **Pajisja e personelit me teknologji moderne** - Janë blerë 70 laptopë të rinj, duke mundësuar pajisjen e rreth 40% të personelit me pajisje portative moderne. Kjo ka rritur fleksibilitetin e punës, ka mbështetur auditimet në terren dhe ka përmirësuar produktivitetin e përgjithshëm.
- Po ashtu, me mjetet e mbetura nga donacioni është siguruar edhe: një altoparlant mobil për nevoja të konferencave dhe prezantimeve zyrtare; një kompjuter me specifika të avancuara për dizajn grafik, në mbështetje të përgatitjes profesionale të raporteve dhe materialeve vizuale.
- **Digjitalizimi i dosjeve të personelit** - Është realizuar digjitalizimi i dosjeve të personelit, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit elektronik të dokumentacionit dhe rritjes së efikasitetit administrativ, transparencës dhe sigurisë së të dhënave.
- **Menaxhimi i aseteve të TI-së** - Janë përgatitur për dorëzim 35 laptopë jashtë përdorimit për shkollat e Kosovës, në kuadër të optimizimit të menaxhimit të aseteve dhe kontributit institucional në mbështetje të komunitetit.

- **Finalizimi i migrimit në Microsoft 365** - Është përmbyllur me sukses migrimi në platformën Microsoft 365, duke mundësuar një mjedis të integruar bashkëpunimi, rritje të nivelit të sigurisë, përmirësim të menaxhimit të dokumenteve dhe komunikimit institucional, si dhe vendosjen e bazës për transformimin e mëtejshëm digjital të institucionit.

Në tërësi, aktivitetet e realizuara gjatë vitit raportues (2025) reflektojnë angazhimin e vazhdueshëm të Departamentit të TI-së për modernizimin e shërbimeve teknologjike dhe për mbështetjen efektive të misionit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.



# 06

**Komunikimi dhe  
Bashkëpunimi me  
Palët e jashtme**

## Kapitulli VI - Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e jashtme

### 6.1. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit

Gjatë vitit 2025, Zyra Kombëtare e Auditimit ka avancuar komunikimin me palët e jashtme, duke rritur transparencën dhe praninë e saj publike. Përmes konferencave për media, punëtorive me gazetarë dhe komunikimit të vazhdueshëm me institucionet, shoqërinë civile dhe partnerët, ZKA-ja ka forcuar ndërveprimin me akterët kyç dhe ka rritur besimin në rolin dhe rezultatet e auditimit. Ky angazhim ka kontribuar në forcimin e prezencës institucionale dhe në thellimin e bashkëpunimit me aktorë kyç në nivel vendor dhe ndërkombëtar.

Paralelisht përmes pjesëmarrjes aktive në konferenca, seminare dhe forume ndërkombëtare të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI dhe mekanizma të tjerë profesional, ZKA-ja ka përfituar nga praktikat më të mira ndërkombëtare dhe ka forcuar pozitën e saj në komunitetin ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit.

#### Takimet e AP-së dhe pjesëmarrja në konferencat dhe tryezat vendore

Me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, rritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes, AP-ja ka pritur në takim drejtues të institucioneve, përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare si:

- Kryeshefin Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës;
- Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit i Shqipërisë, me bashkëpunëtorë;
- Eksperten nga Agjencia Kroate për Auditimin e Sistemit të Zbatimit të Programeve të BE-së;
- Udhëheqësen e Ekipit të Qeverisjes së Mirë në kuadër të projektit Reforma në Administratën Publike/ Menaxhimi i Financave Publike në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë,;
- Udhëheqësin e ekipit të Bashkimit Evropian për asistencë teknike në mbështetje të reformave në menaxhimin e financave publike,;
- Përfaqësuesit e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë,;
- Drejtoreshën e Departamentit për Demokratizim në OSBE;
- Rektoren e Universitetit për Biznes dhe Teknologji;
- Kryetarin e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës - OIRK anëtarin e Bordit të Odës së Arkitektëve të Republikës së Kosovës - OARK,;
- Delegacionin nga Autoriteti i Ankesave të Prokurimit Publik të Tanzanisë; si dhe
- ZKA-ja u vizitua nga përfaqësuesit e Qendrës për Ekselencë në Financa - CEF.

Po ashtu AP-ja mori pjesë në konferenca, punëtori dhe tryeza si:

- Aktivitetin e organizuar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas nga Agjencia për Barazi Gjinore, ku u prezantua Rrjeti i Grave në Pozita Vendimmarrëse në Administratë Publike dhe Institucione të Pavarura;
- Tryezën “Fuqizimi i Sistemit të Prokurimit Publik në Kosovë”;
- Punëtorinë “Si t’i evitojmë shkaqet kryesore që çojnë në opinionin e kualifikuar të auditimit”;
- Konferencën “Epoka e inteligjencës artificiale - teknologjia si mjet, vlerat si mision”;
- Konferencën “Fuqizimi i sistemit të prokurimit publik - raportet vjetore dhe bashkëpunimi ndërinstytucional”;
- Tryezën “Parandalimi i korrupsionit në prokurimin publik”; si dhe
- Tryezën “Progresi dhe sfidat në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit”.

### Punëtoritë dhe tryezat e organizuara nga ZKA-ja

Në muajin maj Zyra Kombëtare e Auditimit organizoi në Prishtinë punëtorinë dyditore me temën “Auditimet e Teknologjisë së Informacionit – Zhvillimet dhe Sfidat”, e cila bashkoi përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Turqia, Polonia, Estonia, Portugalia, përfaqësues nga IDI, nga Universiteti i Tartu-së, konsulent kryesor nga GRC – Bitsecura, si dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Ky aktivitet shërbeu si platformë për të diskutuar zhvillimet, sfidat dhe mundësitë në fushën e auditimeve të TI-së në sektorin publik.



UN Women në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë dhe Zyrën Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut, kanë mbajtur punëtorinë rajonale “Nisma për auditime të reja të përbashkëta të performancës”. Ngjarja mbledhi përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të tri shteteve dhe partnerë të tjerë, për të diskutuar mundësitë e zhvillimit të auditimeve të përbashkëta me fokus në fuqizimin e grave në vendimmarrje dhe barazinë gjinore.



ZKA-ja në qershor organizoi tryezën e diskutimit “Propozim plani për auditimet e performancës” për sezonin auditues 2025/2026. Përfaqësuesit e një numri të konsiderueshëm të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të shoqatave profesionale si dhe përfaqësues të institucioneve kanë dhënë kontributin e tyre duke propozuar tema për auditime të performancës në fusha me interes publik që mund të përfshihen në Planin Vjetor të Auditimit.



Tryeza me OSHC

Në tetor mbajti Konferencën Vjetore me temën “Auditimi që nxit ndryshim – Profesionalizmi dhe Besueshmëria”, punimet e së cilës u zhvilluan në tri panele: “Roli i auditimit në fuqizimin e qeverisjes së mirë përmes zbatimit strategjik, zhvillimit profesional dhe cilësisë në punë”; “Auditimi i PVF-ve, pajtueshmërisë dhe performancës”; si dhe “Ndryshimet rregullative, bashkëpunimi dhe mbështetja administrative”. Në kuadër të paneleve u prezantuan rezultatet e punës audituese, zhvillimi strategjik dhe i metodologjisë, ndryshimet në kornizën rregullative, komunikimi, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja administrative si dhe sfidat dhe sukseset.



Konferenca Vjetore

Në muajin dhjetor Zyra Kombëtare e Auditimit, realizoi aktivitetin tradicional të dhurimit të gjakut, i organizuar me iniciativën e Sindikatës së ZKA-së, në bashkëpunim me Qendrën Kosovare të Transfuzionit të Gjakut. Aktiviteti u zhvillua me sukses dhe dëshmoi angazhimin e vazhdueshëm të ZKA-së për humanizëm dhe mirëqenie shoqërore.

Edhe gjatë vitit 2025, ZKA-ja fokus të veçantë i ka dhënë edhe bashkëpunimit dhe partneritetit me mediet. Ky komunikim është avancuar përmes konferencave për medie, komunikatave dhe aktiviteteve tjera të ndryshme.

ZKA  
të au

Zyra  
të pe  
civile  
preza  
e per  
nevo  
të ob  
u pre  
infra  
pjesë  
prok  
publi  
dhe t  
ekzis

## Konferencat për medie të Auditorës së Përgjithshme gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, mbajti tri konferenca për medie, përmes të cilave prezantoi rezultate kryesore të auditimit duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe informimit publik.

**18 mars 2025** - U prezantua Plani Vjetor i Auditimit 2024/25 dhe rezultatet e tri auditimeve të performancës dhe pajtueshmërisë si: “Efikasiteti dhe efektiviteti në procesin e ndërtimeve të larta në Komunën e Prishtinës”, “Efikasiteti në realizimin e projektit - Rehabilitimi i Linjës 10 Hekurudhore Hani i Elezit - Leshak”, dhe “Menaxhimi i kontratës - Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës në deponitë sanitare dhe stacionet e transferit në Kompaninë e Menaxhimit të Deponive në Kosovë”.



18.03.2025



04.07.2025

**4 korrik 2025** - U prezantuan rezultatet e auditimit për sezonin auditues 2024/2025, që përfshijnë 96 institucione publike, prej tyre 49 të nivelit qendror, 38 të nivelit lokal dhe nëntë ndërmarrje publike.

**3 shtator 2025** - U prezantuan rezultatet e Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2024, si dhe rezultatet e 17 auditimeve (nëntë të performancës dhe tetë të pajtueshmërisë).



03.09.2025



03.09.2025

## ZKA-ja forcon bashkëpunimin me mediet lokale për transparencë dhe llogaridhënie publike

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë vitit 2025 prioritet kishte bashkëpunimin me mediet lokale duke organizuar punëtori rajonale në qytetet kryesore të Kosovës, duke përfshirë Pejë, Gjilanin, Prizrenin, Mitrovicën e Jugut dhe Prishtinën. Qëllimi i këtyre punëtorive ishte të forcohet bashkëpunimi me mediet lokale, të informohen gazetarët mbi proceset e auditimit dhe të promovohet transparenca dhe llogaridhënia publike. Pjesëmarrësit ndanë përvoja dhe pritshmëri, duke theksuar rëndësinë e vazhdimet të bashkëpunimit për një qeverisje më të hapur dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve.

Aktivitetet dhe raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Auditorës së Përgjithshme gjatë vitit 2025 janë prezantuar në mënyrë të mirë nga mediet, ku janë publikuar gjithsej 982 artikuj. Ndërsa zyrtarët e ZKA-së kanë pasur 12 paraqitje në medie, prej tyre tetë intervista dhe katër deklarata.



## Marrëveshjet e nënshkuara me shoqatat profesionale

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqatat profesionale ZKA-ja ka ripërtërirë marrëveshjen e bashkëpunimit për ofrimin e programit të trajnimeve për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional me Shoqatën për Kontabilist të Çertifikuar dhe Auditor të Kosovës.

Po ashtu është nënshkruar marrëveshja me Institutin AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar, e cila ka për qëllim zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të personelit të ZKA-së nëpërmjet programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

ZKA-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës – OIRK-në me qëllim të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional në fushat me interes të përbashkët.

## 6.2. Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës

Bashkëpunimi me Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2025 është zhvilluar përmes komunikimit dhe koordinimit të vazhdueshëm me administratën e Kuvendit, duke siguruar një rrjedhë të rregullt të shkëmbimit institucional të informacionit.

Pavarësisht mosfunksionimit të rregullt të Kuvendit dhe komisioneve të tij gjatë periudhës raportuese, Zyra Kombëtare e Auditimit, në cilësinë e institucionit të pavarur kushtetues dhe ligjor, ka vijuar përmbushjen e obligimeve të saj raportuese në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dorëzuar në administratën e Kuvendit raportet vjetore dhe periodike, duke respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara me ligj.

## 6.3. Bashkëpunimi me organet e sundimit të ligjit

Në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm ka obligim të njoftojë organet kompetente për zbatimin e ligjit në rastet kur identifikon shkelje ligjore.

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Prokurorisë së Shtetit, ka për synim kryesor forcimin e bashkëpunimit në trajtimin e rasteve që rrjedhin nga raportet e auditimit të ZKA-së.

Departamenti për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimit në kuadër të Zyrës Kombëtare të Auditimit, gjatë vitit 2025, ka dërguar 80 raste në Prokurorinë e Shtetit, të cilat janë identifikuar nga raportet e auditimit. Identifikimi i këtyre rasteve kryesisht ka përfshirë procesin e prokurimit, lidhjen e kontratave, si dhe shpenzimet në kategoritë e investimeve kapitale, subvencioneve, mallrave dhe shërbimeve.

## 6.4. Sinjalizimet e pranuar gjatë vitit 2025

Zyra Kombëtare e Auditimit ka pranuar gjithsej **31 sinjalizime** nga qytetarë, zyrtarë publikë, organizata joqeveritare dhe palë të tjera të interesit. Këto sinjalizime kanë adresuar çështje që lidhen me parregullsi administrative, shkelje të procedurave të prokurimit, dyshime për konflikt interesi, keqpërdorim të fondeve publike, mosrespektim të kontratave, si dhe praktika të tjera të mundshme në kundërshtim me ligjin dhe standardet e menaxhimit publik.

Nga këto sinjalizime, **14 raste janë trajtuar brenda vitit 2025**, ku një pjesë e tyre kanë rezultuar edhe me **gjetje të rëndësishme** që janë reflektuar në vlerësimet tona profesionale ose janë adresuar tek institucionet kompetente për veprime të mëtejshme. Procesi i trajtimit është zhvilluar në përputhje me metodologjinë e auditimit dhe me procedurat e vlerësimit të rrezikut të brendshëm.

Ndërsa **17 sinjalizimet e mbetura** janë planifikuar të trajtohen gjatë vitit 2026, pasi natyra e tyre lidhet drejtpërdrejt me **planin e auditimit për vitin 2026**, i cili është në proces zbatimi. Këto raste janë përfshirë në analizën e rrezikut dhe do të trajtohen në kuadër të angazhimeve të përcaktuara për institucionet përkatëse.

Rritja e numrit të sinjalizimeve tregon për besimin gjithnjë e më të madh të publikut në mekanizmat e llogaridhënies, si dhe për rolin e ZKA-së në promovimin e transparencës, integritetit dhe menaxhimit të mirë të fondeve publike. Trajtimi i këtyre rasteve kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e qeverisjes së mirë dhe në orientimin e auditimeve të ardhshme, të bazuara në rrezik dhe nevoja publike.

## 6.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar me ISA-të partnere, Marrëveshjet Dypalëshe dhe pjesëmarrja në konferenca e punëtori



Në janar Auditorja e Përgjithshme dhe Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, me bashkëpunëtorë u pritën në takim bilateral në Londër nga Kontrollori dhe Auditori i Përgjithshëm i Mbretërisë së Bashkuar. Krerët e të dy institucioneve shprehën gatishmërinë për një partneritet të qëndrueshëm, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në auditimin financiar dhe të performancës.



Marrëveshja  
ZKA-CIPFA

Në kuadër të vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, AP-ja e shoqëruar nga ZvAP-ja ka vizituar Institutin e Miratuar të Financave Publike dhe Kontabilitetit ku u prit në takim nga Kryeshefi Ekzekutiv i saj, me të cilin kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit përmes së cilit synohet të avancohet përdorimi efektiv dhe i përgjegjshëm i fondeve publike dhe të rritet cilësia e shërbimeve publike në Kosovë.



Takimi i AP-së  
me AP e Uellsit

Po ashtu gjatë kësaj vizite AP-ja dhe ZvAP-ja kanë vizituar Zyrën Kombëtare të Auditimit të Uellsit, ku janë pritur në takim nga Auditori i Përgjithshëm i Uellsit. Homologët u zotuan për të promovuar transparencën dhe integritetin në menaxhimin e financave publike.



Takimi i AP-së  
- Kryetari i KLSH

Në muajin prill me ftesë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë AP-ja mori pjesë në hapjen e aktiviteteve për kremtimin e 100-vjetorit të krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.



Takimi i AP-  
AP i Sllovenisë

AP-ja në muajin prill ka zhvilluar vizitë zyrtare në Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë me ftesë të kryetares së kësaj gjykate. Qëllimi i vizitës ishte shkëmbimi i përvojave profesionale dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushën e auditimit publik.



Në maj AP-ja dhe një delegacion i ZKA-së morën pjesë në seancën solemne të shënimit të 100-vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë. AP-ja tha se ky përvjetor shekullor nuk është thjesht një datë në kalendar, por dëshmi e qëndrueshmërisë institucionale, e besnikërisë ndaj shërbimit publik dhe përkushtimit të palodhur për

forcimin e llogaridhënies dhe integritetit në qeverisje publike.

AP-ja dhe ZvAP-ja u pritën në takim nga Drejtori i Agjencisë për Auditimin e Sistemit të Zbatimit të Programeve të Bashkimit Evropian. Takimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe agjencisë kroate, me theks të veçantë në shkëmbimin e përvojave dhe përmirësimin e praktikave të auditimit në përputhje me standardet evropiane.

Gjatë muajit korrik AP-ja dhe ZvAP-ja realizuan vizitë dypalëshe në Zyrën Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut në Shkup. AP-ja u prit në takim nga homologu i saj, takimi u fokusua në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira të auditimit.



Në muajin tetor AP-ja dhe një delegacion i ZKA-së morën pjesë në Kongresin XXV të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI). Kongresi përfaqëson ngjarjen më të rëndësishme botërore në fushën e auditimit publik duke mbledhur përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit anëtare të INTOSAI-t, partnerë dhe ekspertë ndërkombëtarë.





Në margjinat e Kongresit XXV të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI), AP-ja pati një takim të veçantë me Presidentin e Gjykatës së Përgjithshme të Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, të cilin e falënderoi për bashkëpunimin e deritanishëm, me theks të veçantë për mbështetjen ndaj ZKA-së përmes donacionit nga Fondi Saudit për Përmirësimin e Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (FISP).

Po ashtu AP-ja mori pjesë në sesionin “Fondi Saudit për Përmirësimin e Performancës së ISA-ve (FISP)” organizuar nga Gjykata e Përgjithshme e Auditimit të Mbretërisë së Arabisë Saudite dhe Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t. Në kuadër të këtij sesioni, institucionet përfituese prezantuan rezultatet e arritura dhe ndikimin e fondit në rritjen e performancës dhe lehtësimin e sfidave të hasura në punën e tyre të përditshme.

Gjithashtu në një ceremoni të veçantë të organizuar në kuadër të Kongresit XXV të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit - INCOSAI, AP-ja në emër të auditores seniore, pranoi çmimin ndërkombëtar për Programin “Auditimi i së Ardhmes së Barabartë” - EFA nga Drejtori i Përgjithshëm i Iniciativës së INTOSAI-t për Zhvillim (IDI). Ky çmim ndërkombëtar i dedikohet znj. Kryeziu-Qehaja për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në avancimin e auditimit me fokus në barazi dhe përfshirje në kuadër të programit “Auditimi i së Ardhmes së Barabartë”.

AP-ja mori pjesë në shënimin e 26-vjetorit të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut. AP-ja uroi homologun e saj për këtë përvjetor të rëndësishëm si dhe vlerësoi lartë punën e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e auditimit publik.

### Pjesëmarrja e ZKA-së në konferencat dhe punëtoritë ndërkombëtare



AP-ja më 3 dhe 4 qershor mori pjesë në Konferencën e nivelit të lartë me temën “Siguria e vendeve të BE-së nga perspektiva e Institucioneve Supreme të Auditimit”, organizuar në Varshavë nga Institucioni Suprem i Auditimit të Polonisë, në kuadër të Presidencës Polake të Këshillit të Evropës.



AP-ja mori pjesë në konferencën “Besimi në financat publike: perceptimet kundrejt praktikës”, organizuar më 10-11 qershor 2025 në Zagreb nga CEF dhe CIPFA. Gjatë fjalës në seancën plenare me temën “Studim rasti – Vlerësimet e Barometrit Ballkanik dhe standardet ndërkombëtare të auditimit”, znj. Spanca prezantoi përvojën e Kosovës dhe rolin kyç të ZKA-së në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet publike.



AP-ja mori pjesë në Seminarin Vjetor të Auditorëve, ku në hapje të punimeve theksoi rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në forcimin e besimit të qytetarëve, domosdoshmërinë e ruajtjes së pavarësisë institucionale dhe sfidat me të cilat përballen.

Përfaqësuesit e ZKA-së morën pjesë në një sërë aktivitete profesionale, përfshirë Konferencën shkencore të KLSH-së “Ndërtimi i institucioneve të adaptueshme: Përshtatja me dinamikën e mjedisit – Një perspektivë e auditimit të jashtëm”; Takimin e tretë të Projekt Grupit të EUROSAI SG1 “Përfitimet dhe metodologjitë e auditimit në kohë reale”; si dhe Seminarin “Vlerësimi i performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit”.

Ata ishin pjesë e Takimit të Zyrtarëve Ndërlidhës të Rrjetit të ISA-ve të vendeve candidate dhe candidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Evropian, me pjesëmarrjen e SIGMA-s, Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe Grupit për Aktivitete të Përbashkëta në Auditim (JWGAA), si dhe të takimit të Zyrtarëve Ndërlidhës të Komitetit të Kontaktit.

Gjithashtu, përfaqësuesit e ZKA-së morën pjesë në Punëtorinë rajonale “Auditimi i Prokurimit Publik – Praktika dhe Inovacione”; Seminarin VIII “Roli dhe ndikimi i ISA-ve në zbatimin dhe zhvillimin e politikave rajonale”; Takimin IX vjetor të Grupit Punues të EUROSAI-t për Auditimin e Komunave (WGMA); Punëtorinë për Siguri Kibernetike II; Konferencën “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit”; si edhe në Seminarin e parë të EUROSAI-t për ndërtimin e kapaciteteve.

Ata morën pjesë edhe në Takimin e shtatë të Nënkomitetit BE-Kosovë për Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika; Punëtorinë e tetë të EUROSAI-t për Analizën e të Dhënave, Efikasitetin dhe Metodën e Krahasimit; Punëtorinë e parë të Projekt Grupit për Aktivitetet e Zhvillimit të EUROSAI-t; Seminarin “Institucionet Supreme të Auditimit, Inteligjenca Artificiale dhe Etika” në Lisbonë; si dhe në një vizitë studimore në Romë, të zhvilluar në kuadër të Projektit kundër Krimin Ekonomik (PECK III), bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

## Projekti i bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë



Gjatë këtij viti Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës (ZKA) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (ZKAS) kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për bashkëpunim në zhvillimin institucional për periudhën 2025-2030, duke thelluar partneritetin e suksesshëm që nga viti 2011. Memorandumi i nënshkruar nga Auditorja e Përgjithshme e Kosovës, Vlora Spanca, dhe Auditorja e Përgjithshme e Suedisë, Christina Gellerbrant Hagberg, synon forcimin e mëtejme të kapaciteteve të ZKA-së për të punuar në përputhje

me standardet më të avancuara ndërkombëtare të auditimit.

Ky bashkëpunim shumëvjeçar do të fokusohet në tri fusha kyçe si: menaxhimi strategjik, auditimi i performancës, si dhe lidhshimi dhe komunikimi i brendshëm. Përmes këtij projekti, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë do të ofrojë mbështetje profesionale dhe teknike, përfshirë shkëmbimin e ekspertizës, angazhimin e konsulentëve dhe mbulimin e kostove për aktivitetet e përbashkëta.

Në kuadër të këtij projekti në shtator një delegacion i ZKA-së i udhëhequr nga Zëvendës Auditori i Përgjithshëm, qëndroi për vizitë zyrtare në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë (ZKAS) në Stokholm.

Në vazhden e zbatimit të projektit me ZKAS u mbajtën dy punëtori, trajnime dhe sesione konsultuese për zhvillimin e aftësive për udhëheqje, menaxhim dhe komunikim të brendshëm, nga ekspertët e ZKA-së së Suedisë. Po ashtu ZKA-ja në bashkëpunim me ekspertët suedezë në shtator mbajti punëtorinë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit.

## Takimi i radhës mes ZKA-së dhe KLSH-së për auditimin paralel mbi sigurinë e digave



Në kuadër të bashkëpunimit profesional ndërmjet Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, me 29 dhe 30 maj 2025 u mbajt takimi i radhës në Prishtinë për realizimin e auditimit paralel të performancës me temë “Mbrojtja dhe siguria e digave”.

Ekipet diskutuan për temën e auditimit dhe objektivat e përbashkëta për të vlerësuar menaxhimin dhe masat e sigurisë në digat e të

dy vendeve, metodologjinë, qasjet e përdorura dhe përputhshmërinë e planeve të auditimit, memon parastudimore dhe çështje tjera të procesit të auditimit. Ekipet gjithashtu koordinuan aktivitetet e ardhshme për auditim të përbashkët i cili synon të kontribuojë në forcimin e përgjegjësisë institucionale dhe mbrojtjen e interesit publik. Ata gjithashtu, prezantuan dhe diskutuan rezultatet e punës së deritanishme.

Në kuadër të këtij takimi u zhvillua edhe një vizitë në digën e Liqenit të Batllavës ku ekipet panë nga afër gjendjen në terren.

### **Përfaqësueset e ZKA-së morën pjesë në punëtorinë ndërkombëtare të EUROSAT-t në Stamboll**

Përfaqësues nga institucionet supreme të auditimit morën pjesë në një punëtori ndërkombëtare të EUROSAT-t në Stamboll, ku morën pjesë vendet e rajonit dhe më gjerë. Punëtorja u fokusua në të gjithë procesin e auditimit, nga planifikimi dhe mbledhja e provave, deri te menaxhimi i cilësisë, raportimi dhe angazhimi me palët e interesit për rritjen e ndikimit. Gjatë sesioneve interaktive, pjesëmarrësit ndanë përvoja, praktika të mira dhe sfida të hasura në proceset e auditimit. Përfaqësuesit kontribuan në diskutime mbi auditimet e orientuara drejt rezultateve dhe avancimin e metodologjive për forcimin e transparencës, komunikimit dhe cilësisë. Projekti synon mbështetjen e institucioneve të auditimit për zhvillim profesional dhe përshtatje të praktikave më të mira. Fushat e zhvillimit do të përcaktohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet pjesëmarrëse.

### **ZKA-ja kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve audituese në nivel rajonal**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës vazhdon të kontribuojë në ndërtimin e kapaciteteve profesionale në nivel rajonal për auditime të performancës. Në një program trajnimi të organizuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë (ZKAS) në Sarajevë, pjesëmarrës nga vendet e rajonit morën pjesë në aktivitete praktike dhe shkëmbim përvojash profesionale, në përputhje me standardet e INTOSAT-t. Mentorët e ZKA-së ofruan udhëzime teorike dhe praktike për zhvillimin e aftësive metodologjike, analitike dhe komunikuese të auditorëve. Trajnimi synon rritjen e profesionalizmit dhe promovimin e standardeve të larta në auditimet e performancës. Auditorët pjesëmarrës do të certifikohen pas përfundimit të programit, duke rritur numrin e auditorëve të çertifikuar të ZKA-së. Ky angazhim nënvizon rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të përvojave, si dhe forcon kapacitetet institucionale dhe avancimin e praktikave më të mira të auditimit.

## **6.6. Vlerësimet për ZKA-në nga palët e jashtme për vitin 2025**

**Sipas raportit të Barometrit Ballkanik** të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon të gëzojë nivel të lartë besimi publik, duke u vlerësuar pozitivisht për pavarësinë dhe rolin e saj në mbikëqyrjen e punës së qeverisë. Shqipëria dhe Kosova renditen ndër vendet me besimin më të lartë ndaj Institucioneve Supreme të Auditimit në rajon, ku 47% e të anketuarve në Kosovë vlerësojnë se këto institucione shqyrtojnë në mënyrë efektive punën e qeverisë. Raporti gjithashtu e pozicionon Kosovën në mënyrë pozitive sa i përket perceptimit për ruajtjen e pavarësisë nga ndikimet politike.

**Sipas Raportit të Progresit 2025**, të publikuar nga Komisioni Evropian, Zyra Kombëtare e Auditimit ka arritur progres të rëndësishëm në forcimin e auditimit të jashtëm, rritjen e cilësisë së auditimit dhe avancimin e transparencës dhe llogaridhënies publike në Kosovë. Raporti vlerëson përparimin në zbatimin e Planit Strategjik 2023–2026, zhvillimin e auditimeve, përfshirë ato të performancës dhe të Teknologjisë së Informacionit, si dhe përmirësimin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, duke theksuar njëkohësisht nevojën për rritjen e nivelit të zbatimit të tyre nga institucionet publike.

# 07

**Llogaridhënia dhe  
aktivitetet e vitit  
2025**

## Kapitulli VII – Llogaridhënia dhe aktivitetet e vitit 2025

### 7.1. Llogaridhënia e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Pasqyrat Vjetore Financiare të ZKA-së janë dorëzuar dhe janë përfshirë në Raportin e Qeverisë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2026, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Për vitin 2025, Kuvendi i Kosovës nuk ka angazhuar një kompani audituese për të kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të ZKA-së, prandaj në këtë raport janë përfshirë pasqyrat e paaudituar.

Në kuadër të raportimit financiar dhe të performancës, ZKA-ja është llogaridhënëse sipas nenit 138 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.

### 7.2. Aktivitetet e ZKA-së gjatë vitit 2025

Ky dokument jep një përmbledhje të aktiviteteve dhe progresit të Zyrës Kombëtare të Auditimit gjatë zbatimit të Planit Strategjik 2023–2026. Ai pasqyron përpjekjet për forcimin e pavarësisë, përmirësimin e standardeve dhe cilësisë së auditimeve, zhvillimin e kapaciteteve të personelit dhe menaxhimin e burimeve, si dhe rritjen e ndikimit dhe imazhit të institucionit. Po ashtu, përfshihen strategjitë e komunikimit dhe të teknologjisë së informacionit, të cilat synojnë të përmirësojnë transparencën, profesionalizmin dhe efektivitetin e punës së ZKA-së.

#### Aktivitete kryesore të vitit 2025 sipas Planit Strategjik:

##### Qëllimi 1: Pavarësia, Standardet dhe Cilësia

- Përmirësimi i kuadrit ligjor sipas INTOSAI-t P-10 për auditime bazuar në rrezik;
- Përditësimi i standardeve, doracakëve dhe udhëzuesve auditues sipas SNISA-ve;
- Zhvillimi i arkivës digjitale dhe rregulloreve të brendshme;
- Rritja e numrit të auditimeve të pajtueshmërisë dhe performancës.

##### Qëllimi 2: Kapacitetet dhe Burimet

- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore përmes digjitalizimit;
- Avancimi profesional i personelit dhe forcimi i kontrolleve të brendshme;
- Fuqizimi i shërbimeve financiare dhe njerëzore;
- Zhvendosja e ZKA-së në një objekt publik të MPB-së në vitet e ardhshme.

##### Qëllimi 3: Imazhi dhe Ndikimi

- Bashkëpunimi për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimi i bazës së të dhënave;
- Komunikimi i rregullt me komisionet parlamentare, shoqërinë civile dhe mediet;
- Pjesëmarrja në aktivitetet e INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

ZKA-ja ndjek një strategji të qartë komunikimi për periudhën 2023–2026, e cila ka dy qëllime kryesore: promovimin e rolit kushtetues dhe ndikimin e auditimeve, si dhe komunikim të brendshëm për mbështetje dhe promovim të rezultateve.

Strategjia e TI-së (2025–2027) synon përshtatjen e teknologjisë me kërkesat e auditimit dhe përfshin: infrastrukturë moderne, teknologji digjitale për përmirësimin e punës, analiza të avancuara dhe inteligjencë artificiale, qeverisje të TI-së dhe zhvillim të vazhdueshëm.



Foto e përbashkët e Personelit të Zyrës Kombëtare të Auditimit - 2025



**SHTOJCA**

## Shtojca I. AUDITIMET PËR SEZONIN 2024/25 DHE 2025/26

Në vitin 2025, për sezonin e auditimit 2024/2025 janë publikuar 133 raporte të auditimit:

### 104 raporte të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë:

- **Raporti Vjetor i Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës, të vitit 2024,**
- **49 institucione të nivelit qendror,**
- **38 komuna,**
- **9 ndërmarrje publike:**
  1. Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a (KEK)
  2. KOSTT
  3. Trepça Sh.A
  4. KRU "Prishtina" sh.a - Prishtinë
  5. Telekom, sh.a
  6. KRM "Uniteti" sh.a - Mitrovicë
  7. Ngrohtorja Qendrore "Termokos" - Prishtinë
  8. NPH "Ibër - Lepenc" sh.a - Prishtinë
  9. Hidrodrini sh.a -Pejë
- **7 projekte të financuara nga donatorët:**
  1. Projekti i Reformës së Sistemit të Asistencës Sociale (BB-MFPT)
  2. Ekonomia Digjitale e Kosovës (BB-MZHE)
  3. Projekti i Kosovës për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme (BB-MZHE-Fondi eficiencë)
  4. Përmirësimi dhe Rehabilitimi i Sistemeve të Ujitjes në Kosovë (BB-MBZHR)
  5. Komunitat për rininë në Kosovë (BB-MAPL)
  6. Projekti për Infrastrukturën e Pasurive të Paluajtshme dhe Gjeohapësinore (BB-AKK)
  7. Programi për nxitjen dhe shfrytëzimin e mundësive për sigurinë e ujit (BB-MMPHI/Hidromorava)
- **14 raporte të auditimit të performancës:**
  1. Efektiviteti i Sistemit për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve në Kosovë
  2. Funkcionimi, licencimi dhe mbikëqyrja e Institucioneve Parashkollore
  3. Mbrojtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore
  4. Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit 2019
